


2017

RAPORTI VJETOR
RAPORTIMI I PARË



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT

RAPORTI VJETOR

— (RAPORTIMI I PARË) —

TIRANË, MARS 2018

TRYEZA E LËNDËS

HYRJE	6
I. KUADRI LIGJOR	8
II. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL	18
III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	22
IV. AKTIVITETI I INSTITUCIONIT	28
i. Drejtoria e Arkivës, identifikimi, kalimi ne administrim i dokumenteve arkivore	30
ii. Drejtoria e Arkivit dhe e Zhvillimit Teknologjik	43
iii. Drejtoria e Informacionit, Informimi i subjekteve për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	48
iv. Drejtoria e Edukimit Qytetar	60
v. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe e Financës	66
V. PROBLEMATIKA DHE VËSHTIRËSI	74
VI. PROPOZIMI PËR PËRMIRËSIM	76
VII. REKOMANDIME DHE DETYRA	78
ANEKSE	81

H Y R J E

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, i përbërë nga 5 anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim AIDSSH) u krijua me Ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 30 mars 2015, ligj i cili u hartua kryesisht duke u bazuar në përvojën dhe modelin e ligjit gjerman mbi aksesin në regjistrat e STAS-it, të miratuar në fillim të viteve 1990 pas ribashkimit të Gjermanisë.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, i përbërë nga 5 anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi, nga radhët e shtetasve të shquar, me integritet të lartë profesional e moral, të cilët kanë përmbushur edhe kriterin e pastërtisë së figurës. Mandati i anëtarit të Autoritetit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Nga radhët e anëtarëve Kuvendi zgjedh kryetarin.

Kuvendi i Shqipërisë në seancat plenare të datës 17.11.2016 dhe 24.11.2016 ka votuar anëtarët për Autoritetin për Informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Kryetaren e këtij Autoriteti.

Fusha e veprimit të Autoritetit shtrihet për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991,

“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar.

Misioni i tij është të sigurojë akses subjekteve të ligjit nr. 45/2015 të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të ruajë të dhënat e dokumenteve në arkivë në mënyrë që të edukojë publikun dhe të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme. Për të përmbushur misionin e tij, Autoriteti gjatë vitit të parë të punës është udhëhequr nga parimet e transparencës, integritetit, bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe unitetit kombëtar, informimit të publikut me informacionin zyrtar, mbrojtjes së të drejtës për jetën private dhe të dhënave personale dhe të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, si dhe efikasitetit dhe efektivitetit.

Autoriteti në hapat e para ka synuar identifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe mbledhjen e tyre nga autoritetet publike dhe rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nga arkivat e Shërbimit Informativ Shtetëror, Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës. Është synuar konsolidimi i një arkive të vetme për të gjitha dokumentet e prodhuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, me qëllim sigurimin dhe dhënien e informacionit për subjektet e ligjit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjatë vitit të parë të punës është punuar paralelisht edhe për mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë

për dhënien e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve. Ndërkohë që proces i rëndësishëm mbetet edhe skanimi i individëve që kërkojnë të aplikojnë në detyra publike, për lidhjet me ish-sigurimin të shtetit.

Dokumenti i Strategjisë për vitet 2017-2020, miratuar me Vendim të Autoritetit nr. 42, datë 22.06.2017 “Për miratimin e Planit Strategjik dhe atij të Veprimit (2017 - 2020) të Autoritetit” ka shërbyer si një dokument udhëzues për aktivitetet e Autoritetit të sapokrijuar. Dokumenti ka për qëllim të ofrojë drejtim dhe fokus për aktivitetet e Autoritetit, duke mundësuar gjithashtu rishikime periodike të qëllimeve dhe objektivave të tij. Përmbledhje e Dokumentit të Strategjisë 2017 – 2020 jepet në *Aneksin nr. 1* të Raportit.

Nën strategjinë e ndërtuar për vitin 2017-2020 është hartuar plani vjetor 2017, në përmbajtje të të cilit janë vendosur objektivat, aktivitetet që do të zhvillohen për të arritur këto objektiva, afati kohor, struktura përgjegjëse që do të realizojë objektivat, si një dokument provues për arritjen e objektivave.

Plani vjetor 2017 ka përcaktuar drejtimet kryesore të punës së Autoritetit për përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin nr. 45/2015, në VKM-në nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e Institucionit.

K U A D R I
L I G J O R





Autoriteti në hapat e para ka synuar identifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe mbledhjen e tyre nga autoritetet publike dhe rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nga arkivat e Shërbimit Informativ Shtetëror, Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës

Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2015 dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij. Autoriteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin organik dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Rregulla të hollësishme për funksionimin dhe veprimtarinë e sekretariatit teknik janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të Autoritetit. Struktura dhe organika e sekretariatit teknik, miratohet nga Kuvendi, me propozim të Autoritetit. Në datë 22.12.2016 është miratuar struktura e Institucionit me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 *“Për miratimin e Strukturës, Organikës dhe Klasifikimin e Pagave të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”*.

1.1 Infrastruktura

Autoriteti me kërkesën e tij, pajiset nga Këshilli i Ministrave me mjedise dhe i krijohen kushtet e nevojshme të punës. Me VKM-në nr. 935, datë 28.12.2016 *“Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, brenda territorit të pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, të ndryshuar”* është përcaktuar ambienti ku do të ushtrojë veprimtarinë e vet Autoriteti.

1.2 Aktet nënligjore

Ligji nr. 45/2015 parashikon, në nenin 43, nxjerrjen e akteve nënligjore, duke bërë ndarjen e akteve konkrete: akte të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe akte të miratuara nga Autoriteti: i) Këshilli i Ministrave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi ligjit nr. 45/2015, miraton aktet nënligjore për procedurën e kalimit në administrim të Autoritetit të materialeve arkivore, të parashikuar nga nenet 14 dhe 15, mënyrën e ruajtjes fizike të tyre, si dhe tarifatat e pagesat, të parashikuara nga neni 25 i këtij ligji; ii) Autoriteti, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, mbështetur në parimet e parashikuara nga neni 4 i këtij ligji.

Gjatë vitit 2017, vit i parë i punës, është plotësuar kuadri ligjor i Institucionit, në zbatim të ligjit nr. 45/2015 si dhe të ligjeve të tjera që shërbejnë për funksionimin e Institucionit të sapokrijuar. Për vitin 2017 janë miratuar nga Autoriteti **18** akte:

1 projekt ligj, dërguar një grupi deputetësh për të ndërmarrë nismën e propozimit;

- ✓ 2 VKM, nga të cilat 1 (një) është ende në proces për tu miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- ✓ 3 Rregullore të brendshme të Institucionit;
- ✓ 3 Udhëzime;
- ✓ 5 modeleve të formularëve;
- ✓ 4 akte, të cilat kanë të bëjnë me miratimin e PBA-së, Programin e transparencës dhe Planin Strategjik viti 2017-2020.

1.2.1 VKM-ja nr. 98, datë 15.02.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivor që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”

Sa i përket kuadrit ligjor, është parë si domosdoshmëri hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për procedurën e kalimit në administrim të Autoritetit të materialeve arkivore, të parashikuar nga nenet 14 dhe 15.

Vendimi nr. 98, datë 15.02.2017 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivor që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike” ka parashikuar dokumentet arkivore që kalojnë nën administrim të Autoritetit, hartimin e programeve të përbashkëta të punës për kalimin e materialit arkivor, ngritjen e grupeve të punës dhe afate kohore konkrete për kalimin nën administrim të Autoritetit të gjithë dokumentacionit arkivor nga autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Në zbatim të VKM-së nr. 98/2017 janë firmosur 2 Marrëveshje Bashkëpunimi, 2 Programe të Përbashkëta pune dhe 3 Urdhra të përbashkëta ndërmjet:

18 Akte

Gjatë vitit 2017, vit i parë i punës, është plotësuar kuadri ligjor i Institucionit, në zbatim të ligjit nr. 45/2015 si dhe të ligjeve të tjera që shërbejnë për funksionimin e Institucionit të sapokrijuar. Për vitin 2017 janë miratuar nga Autoriteti 18 akte.

- i. AIDSSH dhe Ministria e Punëve të Brendshme;
- ii. AIDSSH dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- iii. AIDSSH dhe Shërbimi Informativ Shtetëror.

1.2.2 Projekt vendimi “Për Përcaktimin e Tarifave dhe Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” me Vendim të Autoritetit nr. 3, datë 30.01.2017 është miratuar drafti i projektvendimit “Për Përcaktimin e Tarifave dhe

Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”. Projektvendimi është dërguar zyrtarisht për mendim në Ministrinë e Financave, duke patur parasysh se në të parashikohen edhe kosto financiare për subjektet e përfshira në të. Në vijim, projektvendimi bazuar në seksionin II, pika 2 të VKM-së nr. 834/2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin”, i është dërguar Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin me qëllim bashkërendimin e punës për përgatitjen dhe paraqitjen e projektvendimit “Për caktimin e Tarifave dhe Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që Ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”.

Pas një korrespondence zyrtare është finalizuar

projekt vendimi përfundimtar, pas përfshirjes edhe të sugjerimeve të Institucioneve/Ministrive të përfshira në këtë proces dhe aktualisht Autoriteti është në pritje për miratimin nga Këshilli i Ministrave të projekt vendimit “Për Përcaktimin e Tarifave dhe Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, sipas kërkesave të nenit 43 të ligjit nr. 45/2015.

1.2.3 Rregullorja *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”.*

Sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 45/2015, Autoriteti brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, mbështetur në parimet e parashikuara nga neni 4 i këtij ligji.

Me qëllim ecurinë dhe mbarëvajtjen e punës së Autoritetit dhe të Stafit të Sekretariatit Teknik me Vendimin e Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2014 është miratuar Rregullorja *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”*. Drafti i Rregullores *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”* është konsultuar edhe me përfaqësues të OSBE-së, të cilët kanë dhënë asistencën e tyre në vijimësi dhe zyrtarisht mendimin dhe opinionin e tyre për disa dispozita të Rregullores, nëpërmjet shkresës nr. 232 prot., datë 09.05.2017.

Rregullorja përcakton në mënyrë të hollësishme mënyrën e funksionimit të Autoritetit, mënyrën e thirrjes së mbledhjes dhe organizimi i mbledhjeve të Autoritetit, si organ kolegjal, administrimi i dokumenteve të mbledhjeve të Autoritetit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Autoritetit, dhe të Kryetares së Autoritetit. Po në këtë Rregullore parashikohet dhe funksionimi i të gjithë veprimtarisë së brendshme e Institucionit, stafit të Sekretariatit teknik për organizimin, funksionimin e strukturave të tij, disiplinën e brendshme në institucion, si dhe drejtimin e administrimit e përditshëm të veprimtarisë së tij. Pjesë e kësaj Rregullore janë edhe formularët standarde të krijimit të dosjeve dhe administrimit të dokumentacionit të mbledhjeve.

Sfida e Autoritetit për këtë vit të parë të punës është implementimi i Rregullores së brendshme të Institucionit.

1.2.4 Rregullorja *“Për parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH”*

Me Vendim të Autoritetit nr. 13, datë 14.04.2017 është miratuar Rregullorja *“Për parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH”*, si kërkesë dhe në zbatim të neneve 46 dhe 47 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2003 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit publike”*, i ndryshuar. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2003 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit*

publike”, i ndryshuar ka si qëllimi garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësisve dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 45/2015, neneve 9 dhe 12 që kanë të bëjnë me kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Autoritetit, si dhe me kushtet dhe kriteret për të qenë anëtar i Sekretariatit Teknik, parashikohet qartë se këto subjekte nuk duhet të kenë konflikt interesi me detyrën që ushtrojnë.

Miratimi i kësaj Rregullore, si një kërkesë e ligjit njëkohësisht i shërben edhe punonjësve të AIDSSH-së për shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre funksionale. Pjesë e kësaj Rregullore është edhe formulari për shmangien e konfliktit të interesit në Institucion.

1.2.5 Rregullorja *“Për mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH”.*

Me Vendim të Autoritetit nr. 25, datë 25.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave

Personale në AIDSSH”. Dispozitat e ligjit nr. 45/2015 parashikojnë ndër të tjera edhe parimet si, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe unitetit kombëtar, informimit të publikut me informacionin zyrtar, mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale, transparencës, bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore. Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Parimi i përgjithshëm i këtij ligji është përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe dispozitat e ligjit nr. 45/2015 miratimi kësaj Rregullore i shërbejnë përcaktimit të procedurave dhe marrjes së masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga strukturat e AIDSSH-së, gjatë përpunimit të dokumenteve arkivore si dhe informimin e subjekteve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Pjesë e kësaj Rregullore është edhe formulari për deklaratën e konfidenialitetit plotësuar nga punonjësit e AIDSSH-së.

1.2.6 Urdhrat: 1.2.6.1 *“Mbi politikat dhe Procedurat për Trajtimin e kërkesave individuale për informim pranë Autoritetit” dhe,*

1.2.6.2 “Mbi Politikat dhe Procedurat për Trajtimin e Kërkesave për Informimin e Institucioneve Kushtetuese, Autoriteteve Publike dhe Personave Privatë”.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 3, datë 30.01.2017 është miratuar Urdhri nr. 10, datë 30.01.2017 “Mbi politikat dhe Procedurat për Trajtimin e kërkesave individuale për informim pranë autoritetit”, i cili përcakton mënyrën e trajtimit të kërkesave të subjekteve kërkuar individë sipas Seksionit I të ligjit nr. 45/2015.

Po kështu është miratuar Urdhri nr. 11, datë 30.01.2017 “Mbi Politikat dhe Procedurat për Trajtimin e Kërkesave për Informimin e Institucioneve Kushtetuese, Autoriteteve Publike dhe Personave Privatë”, i cili përcakton mënyrën e trajtimit të kërkesave së subjekteve Institucione Kushtetuese, apo autoriteteve publike dhe personave privatë, sipas Seksionit nr. 2 të ligjit nr. 45/2015.

Urdhrat e mësipërme të miratuara, përveçse qëllimit të garantimit korrekt dhe ligjor të Ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, njëherazi kanë për qëllim të detajojnë rregullat për procedurën standarde që do ndiqet, për trajtimin e i) të kërkesave të qytetarëve për informim, ii) të kërkesave institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe personave privatë, të paraqitura pranë Autoritetit, për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit “Autoriteti”, në funksion të dhënies së informacionit e të njoftimeve mbi dokumentet, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimit të tyre për kërkuar.

1.2.7 *Miratimi i modeleve të formularëve për kërkesë për informim*

Me vendimin e Autoritetit të datës 30.01.2017 është miratuar modeli i formularëve që plotësohen nga kërkuar individë, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së me qëllim për të ardhur në ndihmë të gjithë personave të interesuar, subjekteve të ligjit nr. 45/2015 për të kërkuar informacion mbi dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.

Me vendimin e Autoritetit të datës 30.01.2017 është miratuar modeli i formularëve që plotësohen nga kërkuar Institucione Kushtetuese, apo autoriteteve publike dhe personave privatë, sipas kërkesave të Seksionit nr. 2 të ligjit nr. 45/2015. Ky formular jo vetëm që është publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së, por njëkohësisht është dërguar edhe zyrtarisht të gjitha Institucioneve Kushtetuese dhe autoriteteve publike, me qëllim të standardizimit dhe ardhjes në ndihmë për të lehtësuar procesin e paraqitjes së kërkesës për informim sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2015.

Me Vendimin e Autoritetit të datës 05.05.2017 është miratuar modeli i formularëve që plotësohen nga kërkuar për qëllime studimore, studiuar shkencor dhe media. Formulari përmban të dhëna të domosdoshme për tu plotësuar nga kjo kategori kërkuarish, duke patur parasysh kërkesat Seksionit nr. 3, përkatësisht të neneve 36, 37 dhe 38 të ligjit nr. 45/2015.

3 Formularë

Në janar të vitit 2017, për t'i ardhur në ndihmë kujtudo, institucioni ka miratuar modelet e formularëve që plotësohen nga kërkues individë, kërkues Institucione Kushtetuese, autoriteteve publike, personave privatë si edhe kërkues për qëllime studimore, studiues shkencor apo media. Këto formularë janë publikuar në faqen zyrtare në internet të AIDSSH-së.

1.2.8 Udhëzimi *“Për zbatimin e Vendimit Nr. 701, datë 22.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave “Për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar në fushën Industriale” dhe për Procedurat e Prokurimit të klasifikuar në AIDSSH”.*

Me vendim të Autoritetit nr. 67, datë 03.11.2017 është miratuar Udhëzimi “Për zbatimin e Vendimit Nr. 701, datë 22.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave “Për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar në fushën Industriale” dhe për Procedurat e Prokurimit të klasifikuar në AIDSSH”.

Në nenin 1, pika 3 e ligjit nr. 45/2015 parashikohet se, në funksion të zbatimit të këtij ligji, autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq

sa është e mundur, edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”. Me autorizimin e Kryeministrit nr. 895/1, datë 10.02.2017 “Për të drejtën e klasifikimit origjinal”, Institucioni i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është autorizuar për të bërë klasifikimin origjinal të informacionit “sekret shtetëror” që prodhon Autoriteti në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 22.10.2014, “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, i cili ka dalë në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, si dhe të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, përcakton rregullat që duhet



të ndjekin Institucionet shtetërore në procedurat e prokurimit të klasifikuar.

Miratimi i këtij Udhëzimi vjen si kërkesë dhe është detyrim ligjor për institucionet, sipas pikës 3 të VKM-së nr. 701/2014 që të nxjerrin Udhëzimet përkatëse brenda Institucionit të vet për zbatimin e tij. Mbi këtë kuadër ligjor, bazuar dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” si dhe me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit me nivel klasifikimi është miratuar nga Autoriteti edhe Udhëzimi “Për zbatimin e Vendimit Nr. 701, datë 22.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave “Për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar në fushën Industriale.”

1.2.9 *Programi i Transparencës të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.*

Me Vendim të Autoritetit nr. 19, datë 05.05.2017

është miratuar “Programi i Transparencës të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” dhe publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së. Programi është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 9887, date 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ligjit nr. 119/2014, date 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit” dhe të ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Miratimi i këtij Programi, përveçse është kërkesë e ligjit nr. 119/2014 njëkohësisht në kuadër, të informimit të individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të personave të prekur, palëve të treta gjatë procesit të këtij informimi i shërben dhe marrjes së masave për të bërë transparente për publikun brenda kuadrit ligjor veprimtarinë e Institucionit.

1.2.10 *Miratimi i fazave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020 të AIDSSH-së.*

Me vendimet e Autoritetit nr. 18, datë 02.05.2017 dhe nr. 58, datë 31.08.2017 janë miratuar dy fazat e Programit buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020.

Dokumenti është hartuar në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 15.03.2017 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020” dhe kërkesave të Institucionit të AIDSSH-së. Ky dokument përmban pasqyrat financiare të formateve të miratuara nga Ministria e Financave brenda tavaneve të vitit 2018-2020. Si viti i parë i punës janë vlerësuar kërkesat e paraqitura për mbulimin me mjete financiare të çdo objekti, aktiviteti apo produkti, duke paraqitur dhe argumentuar të detajuara sipas klasifikimit ekonomik, shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime korente dhe kapitale.




1.2.11 Miratimi i propozimeve “Për një shtesë në Ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për Festat Zyrtare e Ditët Përkujtimore”, për përfshirjen e datës 23 gusht si, Dita e Fjongos së Zezë, dita e kujtesës për viktimat e regjimeve totalitare dhe autoritare.

Me vendim të Autoritetit nr. 67, datë 17.11.2017 është vendosur dërgimi i projektligjit “Për një shtesë në Ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për Festat Zyrtare e Ditët Përkujtimore”, të ndryshuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrjen e nismës ligjore nëpërmjet një grupi deputetësh, për përfshirjen e datës 23 gusht si, Dita e Fjongos së Zezë, dita e kujtesës për viktimat e regjimeve totalitare dhe autoritare.

Parlamenti Evropian ka votuar më 4 prill 2009 me 553 vota pro, 44 kundër dhe 33 abstenime rezolutën “Për ndërgjegjen evropiane dhe Totalitarizmin”. Bazuar në këtë rezolutë, 23 gushti u përzgjodh si “Dita evropiane e kujtesës për viktimat e regjimeve totalitare dhe autoritare”. 23 gushti është një datë simbolike, sepse pikërisht në këtë datë, në vitin 1939, u nënshkrua Pakti Ribbentrop-Molotov, sipas të cilit Evropa Lindore ndahej ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë Nacional socialiste. Kjo datë klasifikohet si një memorie historike, si një element në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive. Përfshirja e 23 gushtit në kalendarin e ngjarjeve të kujtesës, përkrah 9 majit, ditës së Evropës dhe 27 janarit, ditës së Holokaustit, e plotëson kuadrin e kujtesës.

The background is a close-up of a handwritten document on aged, yellowish paper. The handwriting is in a cursive script, with some words like 'bēnto' and 'jēē' visible. Two large, semi-transparent numbers, '1' and '2', are overlaid on the page. The number '1' is on the left and the number '2' is on the right, both in a light orange color. The text 'BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL' is centered over the numbers in a white, sans-serif font.

BASHKËPUNIMI
INSTITUCIONAL



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit konsideron shumë të rëndësishme bashkëpunimin me institucionet publike dhe private pasi në tërësinë e tyre këto institucione ndikojnë në punën e Autoritetit.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit konsideron shumë të rëndësishme bashkëpunimin me institucionet publike dhe private pasi në tërësinë e tyre këto institucione ndikojnë në identifikimin, mbledhjen e dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, krijimin e arkivës, informimin e të gjitha subjekteve deklaruese, individë, Institucione Kushtetuese, autoritete publike, media dhe studiues të ndryshëm. Në këtë këndvështrim, institucioni i AIDSSH-së ka bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha institucionet që lidhen me përmbushjen e detyrave që ligji nr. 45/2015 i ka ngarkuar Autoritetit. Bashkëpunimi ndërinstitutional parashikohet dhe në Rregulloren e brendshme të Institucionit. Kështu, gjatë ushtrimit të veprimtarisë

Autoriteti bashkëpunon dhe bashkërendon punën me:

- ✓ Organizata të huaja, rajonale dhe ndërkombëtare që synojnë mbështetjen e procesit të transparencës mbi të kaluarën komuniste dhe viktimat e diktaturës.
- ✓ Konsulentë vendas apo të huaj, institucione publike, organizata partnere, vendase apo të huaja, për përmirësimin dhe modernizimin e veprimtarisë së tij, si dhe për organizimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme.
- ✓ Institucione, organizata të huaja, ndërkombëtare apo vendase, me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe median.
- ✓ Institucionet publike vendas dhe të huaj si dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

6 Marrëveshje

Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Ministrisë së Brendshme




Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror



Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave




Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Komisionerit për të drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri



Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike



Në këtë kuadër është bashkëpunuar ngushtësisht me:

- ✓ Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit; Për aktivitetin “Deputetët për Deputetët”, që Autoriteti ka zhvilluar për përkujtimin e 70 vjetorit të ekzekutimit të Grupit të Deputetëve.
- ✓ Kryeministrinë, për procesin e draftimit dhe finalizimit të VKM-së për kalimin në administrim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga arkivat e mëparshme në arkivën e Autoritetit si dhe për miratimin e VKM-së për kalimin në administrim të godinës së Autoritetit;
- ✓ Autoritetet publike, të cilat disponojnë dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, konkretisht me Shërbimin

Informativ Shtetëror, Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Arkivën e Sistemit të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes;

- ✓ Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në kuadër të asistencës dhe trajnimeve për njohjen me legjislacionin dhe zbatimin në praktikë të ligjit dhe akteve nënligjore që normojnë punën me dokumentet që kanë nivel klasifikimi;
- ✓ Institucionet si: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, ILDKPKI, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Kulturës, Muzeun Kombëtar, Prokurorinë e Përgjithshme;
- ✓ Institucione publike të cilat kanë në fokus të



veprimtarisë së tyre krimet e komunizmit dhe përndjekjen politike;

- ✓ Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes civile, në kuadër të kërkimit të dhënave për subjektet kërkuese për gjeneralitet e plota të tyre, si dhe në kuadër të projekteve dhe aktiviteteve që ka zhvilluar Autoriteti;
- ✓ Universitetet dhe Fakultetet, në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga Autoriteti;
- ✓ Bashkinë e Tiranës, Bashkinë Tepelenë, Shkodër dhe Bashki të tjera, të cilat kanë kontribuar në mbështetjen e aktiviteteve të zhvilluara nga Autoriteti.

Për të vendosur urat e bashkëpunimit Autoritetit ka vlerësuar nënshkrimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Institucionet shtetërore. Në këtë kuadër janë nënshkruar 6 marrëveshje

bashkëpunimi:

- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Ministrisë së Brendshme;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Komisionerit për të drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit dhe Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike;

BASHKËPUNIMI
NDËR KOMBËTAR



Si një Institucion i ri i sapo krijuar, bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë vit të parë të punës ka zënë vendin e vet në veprimtarinë e përditshme të funksionimit të Institucionit. Në vijim jepen bashkëpunime të Autoritetit me homologët tanë të Gjermanisë, Bullgarisë, Rumanisë, Polonisë etj..

1- Në 12 deri në 13 prill të vitit 2017, Autoriteti mori pjesë në një aktivitet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të OSBE-së UNDP-së dhe Ambasadorëve të Zvicrës, Gjermanisë, Bullgarisë në Tiranë por dhe drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Institutit të Studimeve Politike, Instituti i Historisë, Fakulteti i Drejtësisë, Shërbimi Informativ Shqiptar, gazetarë etj. Ky aktivitet konsistonte në diskutimin dhe trajtimin e sfidave që përfshin mbledhja dhe përpunimi i arkivës së ish – sigurimit asgjësimi ose mungesa e dokumentacionit shoqëruar, manipulimi i arkivave, krahasuar me praktikën e institucioneve europiane si ndihmë për AIDSSH në procesin e pasqyrit me vërtetësi të asaj pjese të errët të së shkuarës së shoqërisë shqiptare dhe metodave që përdorën institucionet homologe në vende të ndryshme të Europës. Aktiviteti përfundoi me përgatitjen e një dokumenti strategjik dhe nënshkrimin e tij e vënien në zbatim në punën e Autoritetit për një periudhë 4 vjeçare. Aktiviteti shërbeu për prezantimin e punës së këtij institucioni të ri të pavarur.

2- Përfaqësues të Autoritetit në datën 15-19 Maj 2017, morën pjesë në takim të organizuar midis anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë me anëtarët e Autoritetit të Dosjeve, Berlinnë zyrën e Komisionerit Federal për dosjet e Stasit, Gjermani për të marrë disa detaje nga përvoja gjermane në lidhje me procesin e deklasifikimit të dokumenteve. Pritja e delegacionit dhe urimi i mirëseardhjes u bë në zyrën e Komisionerit Federal për dosjet e Stasi-t, z. Jahn dhe Drejtori i Përgjithshëm z.

Deicke. Gjatë fjalës së tij, z. Jahn vlerësoi vendimin për krijimin e Autoritetit dhe inkurajoi anëtarët e Autoritetit për të kryer sa më mirë detyrën e marrë përsipër, kaq të rëndësishme për transparencën e së kaluarës komuniste në Shqipëri. Në këtë organizim u shkëmbyen eksperiencat me këto vende si dhe u dhanë mendime dhe rekomandime nga ekspertët të Autoritetit Gjerman për ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit sipas rekomandimeve dhe direktivës të BE dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Anëtarët e Autoritetit patën një takim në Bundestag-un Gjerman ku u pritën nga parlamentarët Johannes Selle (CDU) dhe Josip Juratovic (SPD) ku ndanë sfidat e punës për rishikimin e të shkuarës dhe nevojën për mbështetje për një program intensiv shkëmbimesh teknik me Autoritetin e Hapjes së Dosjeve të Stass-it. Përveçse u njohën nga afër me punën dhe përvojën e autoritetit gjerman të hapjes së dosjeve, u hodhën dhe bazat e një bashkëpunimi të mëtejshëm ndërmjet dy institucioneve.

3- Në kuadrin e bashkëpunimit me Institucionet e huaja homologe në datat 30 Maj -1 Qershor 2017 Autoriteti organizoi një seminar të përbashkët në qytetin e Pogradecit me temë “Kontributi i DosCom në dialogun social mbi të shkuarën dhe hapjen e dosjeve në Bullgari” me Komitetin Bullgar për Hapjen e Dokumenteve dhe Informimin mbi Lidhjet e Qytetarëve Bullgarë me Shërbimin Sekret Shtetëror dhe Shërbimin Sekret të Ushtrisë. Në këtë seminar u trajtuan sfidat e identifikimit, grumbullimit dhe përpunimit të dokumenteve arkivore, sfidat për informimin e subjekteve: qytetarë/media/studiuues, fluksi i aplikimeve, sfidat e sigurisë së godinës/dokumenteve arkivore.

4- Në datat 21 dhe 22 Shtator 2017, Autoriteti mori

pjesë në një aktivitet trajnues me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të OSBE-së, Fondacionit Konrad Adenauer Stiftung dhe Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë, dhe me pjesëmarrjen e gazetarëve të rinj dhe studentëve të gazetarisë që u zhvillua në Tiranë, me temë “*Leximi i dosjeve të Sigurimit – sfidat dhe pritshmëritë- 25 vjet më vonë*” ku u prezantuan dhe diskutuan përvojat e mediave të huaja në raport me dosjet sekrete të policisë në vendet komuniste, ngjashmëritë midis diktaturave komuniste demonstruar nëpërmjet shembujve konkretë si psh dosjet e STAZI-t, numri i viktimave, informatorëve, veprimet e paautorizuara etj.

5- Në datat 16-29 shtator 2017, Anëtarët e Autoritetit Z. Altin Hoxha dhe Z. Marenglen Kasmi, nën kujdesin e OSBE, morën pjesë në një trajnim që u organizua në Berlin, Gjermani. Trajnimi u zhvillua sipas një programi të përbashkët të përgatitur midis Autoritetit, OSBE dhe përfaqësuesve të Komisionerit Federal mbi informimin e dosjeve të Stass-it. Anëtarët e Autoritetit u pritën nga Komisioneri dhe morën eksperiencën e duhur për mënyrën e trajtimit të kërkesave, mënyrën e kërkimit në Arkiv, marrëdhëniet dhe mënyrën e komunikimit midis sektorëve procesin e de kodifikimit, anomizimit, mbështetjen për median dhe kërkimin shkencor.

6- Në datat 05-10 Nëntor 2017, Autoriteti ka marrë pjesë në seminarin me temë “Takim me të shkuarën-Shqipëria takim me Gjermaninë 2017” DEALING WITH THE PAST- ALBANIA MEETS GERMANY 2017, mbajtur në Gjermani dhe organizuar nga Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur, Konrad-Adenauer-Stiftung, OSZE Albanien.

7- Në kuadër të ftesës së Shoqërisë “Vatra” në Washington në datat 07-09 Nëntor 2017, përfaqësues të Autoritetit u ftuan të marrin pjesë në takimin për Përkujtimin e 100 Vjetorit të Viktimave të Komunizmit që u organizua në Washington nga Fondacioni për Kujtimin e Viktimave të Komunizimit. Vizita në Kongresin Amerikan u zhvillua nga datat 07-10 Nëntor 2017 në nderim të Viktimave të Revolucionit të Kuq Stalinian. Gjatë ditëve u krye edhe një vizitë në pentagon dhe në përmblyllje të vizitës u shtrua edhe një darkë në mbyllje të ceremonisë ku u shpërndanë edhe çmime. U zhvillua edhe një vizitë të Zëri i Amerikës me z. Elez Biberaj dhe Arben Xhixho ku përfaqësuesit e Autoritetit treguan arritjet e deritanishme dhe sfidat që hasin. Takime u zhvilluan edhe në qendrën Vatra.

8- Në datat 03-05 Dhjetor 2017, Kryetarja e Autoritetit dhe stafi i Autoritetit morën pjesë në Konferencën Vjetore të Rrjetit Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete, të organizuar në Rumani. Ky Rrjet është krijuar nga Autoritetet e ngjashme në disa vende të Evropës (Gjermani, Poloni, Bullgari, Sllovaki, Hungari, Çeki, Rumani), bazuar dhe mbështetur edhe në iniciativën e shprehur në rezolutat Nr. 1096 (1996) dhe Nr. 1481 (2006) të Asamblesë të Këshillit të Evropës, të cilat theksojnë rëndësinë e ndjekjes penale të krimeve të kryera nga regjimet komuniste, rëndësinë për të informuar publikun për këto krime dhe për të hapur arkivat e ish agjencive policive/shërbimeve sekrete.

Në përfundim të kësaj Konference, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të

Shtetit u pranua anëtar me statusin e vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete.

9- Në datat 11-14 Dhjetor 2017, Anëtarë të Autoritetit dhe stafi i Autoritetit morën pjesë në një vizitë studimore trajnuese të organizuara në Bullgarisë pranë autoritetit homolog bullgar, Komitetit Bullgar për Hapjen e Dokumenteve dhe Informimin mbi Lidhjet e Qytetarëve Bullgarë me Shërbimin Sekret Shtetëror dhe Shërbimin Sekret të Ushtrisë. Gjatë vizitës studimore anëtarët dhe stafi i Autoritetit u pritën nga N/kryetari i Komitetit të Hapjes së Dosjeve Z. Ayrush Hadzhi, i cili ishte një ish i përndjekur politik dhe stafi i këtij Komiteti. Gjatë takimeve prezent ishte edhe Ambasadori Bullgar në Shqipëri Mr. Dimitar Arnaudov i cili ishte një mbrojtës dhe bashkëthemelues i ligjit funksional të AIDSSH si dhe ambasadori i Shqipërisë në Bullgari Mr. Qirjako Kureta. Anëtarët e Autoritetit kërkuar miratimin paraprak nga ana e Komitetit Bullgar për anëtarësimin e AIDSSH me të drejta të plota në *Rrjetin Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete*, dhe N/kryetari i Komitetit u përgjigj menjëherë që do të votojë pro anëtarësimin. Gjatë vizitës u morën eksperiencat më të mira për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve arkivore, të shfrytëzimit të tyre, të mënyrës së informimit dhe vendimmarrjes së Komitetit.

Një pjesë e rëndësishme e punës të Autoritetit, në kuadër edhe të *Rrethit të Miqve të Autoritetit*, gjatë vitit 2017 ka qenë vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me organizatat e huaja që zhvillojnë aktivitetin në Shqipëri sikurse edhe me institucionet shqiptare që punojnë me këto

organizata të huaja. Përmendim se, në datën 22.02.2017 Eurodeputeti dhe Raportuesi për Shqipërinë në BE z. Knut Fleckenstein i shoqëruar nga z. Jan Rudolph dhe z. Alvaro Benlloch Miranda, takuan anëtarët Autoritetit, të cilët informuan mbi fillimin e punës të këtij institucioni të ri, mbi aktet ligjore dhe nënligjore.

Z. Knut Fleckenstein këshilloi që Autoriteti të funksionojë në mënyrë të pavarur nga ndikimet politike dhe të marrë gjithë kohën e duhur për të krijuar një produkt korrekt dhe të besueshëm. Kryetarja e Autoritetit e ftoi zyrtarisht Z. Fleckenstein për t'iu bashkuar rrethit të miqve të Autoritetit, kërkesë e cila u pranua me kënaqësi nga Z. Fleckenstein.

Bashkëpunimi me organizata të huaja

1. Bashkëpunimin me UNDP, i cili ka dhënë asistencën për hartimin e Planit Strategjik të AIDSSH, për hartimin e formularëve të aplikimit për individët, institucionet dhe median/kërkuesit, për planin e digjitalizimit të arkivës



së Autoritetit, si dhe mbështetje logjistike për realizimin e aktiviteteve të ndryshme të Kujtesës dhe Memories.

2. Bashkëpunimin me OSBE, nëpërmjet së cilës janë siguruar pajisjet elektronike për Autoritetin si dhe është mundësuar trajnimi i anëtarëve të Autoritetit në Berlin, Gjermani. Njëkohësisht, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit të brezit të ri u nënshkrua Marrëveshja ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe OSBE-së, e cila është miratuar me Vendim të Autoritetit nr. 46, datë 06.07.2017, dhe në bashkëpunim me OSBE-në dhe Fakultetin e Historisë, në datë 15 korrik u organizua vizita me temë mësimore dhe përnjohëse e stafit të Autoritetit dhe studenteve të shkollës verore, në ambientet e ish- burgut të Spacit për trajtimin e së shkuarës komuniste, por dhe për krijimin e një memoriali në këto ambiente.
3. Bashkëpunimi me PERFORM – Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Helvetas Sëiss Intercooperation në bashkëpunim me Universitetin e Fribourg-ut. Për vitin 2017 duke patur parasysh se ky projekt synon mbështetjen e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij në lidhje me kërkimin shkencor dhe edukimin e qytetarëve mbi rishqyrtimin e historisë së vendit kanë filluar bisedimet për vendosjen e urave të bashkëpunimit. Gjatë vitin 2018 do të nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit. Qëllimi i këtij bashkëpunimi



është mbështetja e Autoritetit në kërkimet arkivore dhe krijimi i një platformë interaktive të komunikimit elektronik, për rolin e shkencës dhe kërkimit shkencor gjatë periudhës 1945-1954, me qëllim zhvillimin e një procesi reflektimi publik, bazuar në evidenca mbi kujtesën historike të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, ky bashkëpunim synon të kontribuojë në gjenerimin e punës kërkimore ndërdisiplinore, e cila do të mbështesë Autoritetin në përmbushjen e misionit të tij në lidhje me kërkimin shkencor dhe edukimin e qytetarëve mbi rishqyrtimin e historisë së vendit. Qëllimi final është forcimi i bashkëpunimit midis studiuesve të shkencave sociale dhe përfshirja e kërkimeve të gjeneruara për debate publike të bazuara në evidenca.

4. Bashkëpunimi me Ambasadën Daneze, i cili ka bërë të mundur sigurimin e disa pajisjeve të tilla si: kompjutera, rack, ups apo edhe pajisje zyre: tavolina, rafta etj..
5. Bashkëpunimi me Ambasadën Gjermane, nëpërmjet së cilës është bërë e mundur të sigurohen pajisje shumë të rëndësishme për Autoritetin për realizimin e procesit të dixhitalizimit. Me vendim të Autoritetit nr. 72, datë 30.11.2017 është miratuar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ambasadës Gjermane.
6. Bashkëpunimi me Ministrinë e Integritimit në përgatitjen dhe paraqitjen pranë Komisionit Evropian të aplikimit për financimin e projekteve zhvilluese të Autoritetit nëpërmjet fondeve IPA.

The background is a close-up of a handwritten document on aged, yellowish paper. The handwriting is in a cursive script, likely from a historical or religious text. A large, semi-transparent watermark of the year '2024' is centered over the page. The text 'AKTIVITETI I INSTITUCIONIT' is overlaid in white, uppercase letters, positioned between the '0' and '2' of the '2024' watermark.

AKTIVITETI I
INSTITUCIONIT

Gjatë vitit të parë të punës janë zhvilluar 72 mbledhje të Autoritetit, në të cilat janë marrë 79 vendime. **Stafi i Sekretariatit Teknik ka përgatitur materialet e domosdoshme për çështjet e trajtuara në mbledhjet e Autoritetit, sipas rendit të ditës, në përmbushje të detyrave sipas ligjit nr. 45/2015.**

Megjithëse ende të kufizuar në staf, pavarësisht strukturës së miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, në të cilën janë përcaktuar numri total i punonjësve prej 60, nga buxheti i shtetit është çelur fond për vitin e parë të punës vetë për 20 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë të Autoritetit, të zgjedhur nga Kuvendi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 45/2015. Në këto kushte, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish –Sigurimit të Shtetit ka funksionuar për vitin kalendarik 2017 me 15 punonjës, organikë e cila është plotësuar pas muajit Mars 2017.

Në këtë kuadër, jotë gjitha Drejtoritë/Sektorët, sipas strukturës së miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 janë plotësuar me nëpunës, ndaj stafi nuk ka kryer vetëm detyrat e veta funksionale, sipas përshkrimit të punës, por edhe detyra të tjera të ngarkuara me Vendim të Autoritetit dhe Urdhra të brendshëm dhe në shumë raste edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune. Sipas organikës dhe strukturës së Autoritetit funksionojnë 5 Drejtori, nga të cilat:

- ✓ Drejtorja e Arkivit, e cila funksionon me 2 Përgjegjës Sektori dhe 1 specialist, nga 10 punonjës sipas organikës;
- ✓ Drejtorja e Informacionit, e cila funksionon me 1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori dhe 1 specialist, nga 16 punonjës sipas organikës;
- ✓ Drejtorja e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve, në të cilën nuk është punësuar asnjë person, nga 6 punonjës sipas

- organikës;
- ✓ Drejtoria e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik, e cila funksionon vetëm me 1 specialiste, nga 6 punonjës sipas organikës;
- ✓ Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe e Financës, e cila funksionon me 2 Përgjegjëse dhe 3 specialist, nga 13 punonjës sipas organikës.

Stafi i Sekretariatit Teknik ka ndihmuar Autoritetin në kryerjen e funksioneve të tij, duke krijuar kushtet e nevojshme për realizimin e mbledhjeve të Autoritetit dhe përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve.

4.1 Drejtoria e Arkivit

Ligji nr. 45/2015 ka parashikuar si detyrë parësore identifikimin dhe më pas grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo është një nga përgjegjësitë kryesore që ligji ka parashikuar për tu përmbushura nga Autoriteti.

Për identifikimin dhe mbledhjen e dokumenteve parashikohet detyrimi i të gjitha autoriteteve publike dhe arkivave të mbështesin Autoritetin në gjetjen dhe mbledhjen e dokumenteve. Ky proces funksionon në dy mënyra: 1. *Vënia në dijeni e Autoritetit, kryesisht, nga autoriteti publik apo arkiva* kur këto janë në dijeni apo konstatojnë, gjatë përmbushjes së detyrave, se zotërojnë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit apo kopje ose dublikata të tyre dhe 2. *Me kërkesë të Autoritetit*, kur ky ka arsye të mendojë se dokumente të caktuara mund të gjenden pranë një autoriteti publik apo arkive. Detyrimi për vënien në dijeni të Autoritetit

mbi ekzistencën e dokumenteve dhe vënien në dispozicion të tyre, rëndon edhe mbi *personat fizikë ose juridikë privatë*. Mos përmbushja e këtij detyrimi prej këtyre të fundit përbën *kundërvajtje administrative*.

Që në ditët e para të fillimit të funksionimit të Autoritetit është kërkuar zyrtarisht bashkëpunimi me autoritetet publike, të cilat administrojnë dokumente arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit. Autoriteti i është drejtuar Shërbimit Informativ Shtetëror, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Arkivës së Sistemit Gjyqësor, pranë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim identifikimin e dokumenteve arkivore që disponoheshin prej tyre, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2015.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të VKM-së nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike” janë firmosur Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave në datën 05.05.2017 dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme në datën 19.05.2017, si dhe Urdhri i Përbashkët me Shërbimin Informativ Shtetëror në datën 26.06.2017.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga Autoriteti, SHISH me shkresën nr. 160 prot., datë 18.01.2017

“Informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” ka listuar të gjitha llojet e fondeve të ish – Sigurimit të Shtetit që administrojnë si dhe mjetet të tjera ndihmëse, si kompjutera të cilat përdoren për shfrytëzimin sa më shpejt të fondit arkivor.

Ministria e Brendshme me shkresën nr. 11/1 prot., datë 23.01.2017 “Mbi fondin Arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, nën administrimin e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme” kë vënë në dijeni Autoritetin për fondet që ajo disponon, duke i listuar të gjitha fondet që administrojnë Arkiva e Sistemit të kësaj Ministrie.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave me shkresën nr. 6903/1 prot., datë 27.01.2017 “Përgjigje kërkesës për informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” ka bërë me dije Autoritetin për dokumentet arkivore që ajo disponon në kuptim të ligjit nr. 45/2015, duke listuar dokumentacionin, i cili gjendet në fondet e disa dikastereve që ndodhen në këtë arkivë.

Arkiva e Sistemit Gjyqësor, pranë Ministrisë së Drejtësisë ka bërë me dije mbi fondin që ajo disponon, të cilat i përkasin dosjeve penale të marra në dorëzim nga disa gjykata, por këto fonde janë të papërpunuara prej tyre, duke kërkuar kohë për përpunimin dhe më pas vijimin e procedurave të mëtejshme.

Ministria e Mbrojtjes ka kthyer përgjigje se nuk dispononte dokumentacion arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit.

Fondet e identifikuar janë pasqyruar në *Aneksin nr. 2* të Raportit.

Në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 45/2015 ka VKM-ja nr. 98, datë 15.2.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të Ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në Autoritetet e tjera publike”.

Sipas Ligjit nr. 45/2015 dhe VKM-së nr. 98/2017 Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) dhe autoritetet e tjera publike duhet t’i dorëzojnë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të gjithë materialin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga data 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, pavarësisht nga data e grumbullimit të këtyre dokumenteve në arkiv.

Ligji nr. 45/2015 në nenin 3, pika 5 të tij ka përkufizuar termin “Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit”. Në kuptim të ligjit dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit janë:

- ✓ të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar:
- ✓ dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;
- ✓ riprodhimet, kopjimet e tyre dhe publikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe
- ✓ mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për

- përpunimin automatik të të dhënave;
- ✓ dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit;
 - ✓ dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 98/2017 në pikën 1, parashikon dokumentacionin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. Në këtë dokumentacion përfshihen:

- ✓ të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, që mund të jenë dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;
- ✓ riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore;
- ✓ mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;
- ✓ dokumentacioni shoqërues, procesverbalet, aktet e dorëzimit dhe aktet e marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni që prej datës së krijimit të tyre;
- ✓ raportet e detajuara për të gjitha lëvizjet, ndryshimet, rigrupimet, dëmtimet dhe humbjet që ka pësuar fondi i dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit si

edhe dokumentacioni tjetër i sipërpërmendur, prej datës 2 korrik 1991 e në vijim;



- ✓ konstatimet, informacionet, urdhrat dhe raportet e hartuara, që kanë lidhje me menaxhimin, sistemimin, inventarin dhe gjendjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që janë grumbulluar në arkivin e institucioneve prej krijimit të tyre;
- ✓ çdo informacion mbi procesverbalet e inventarizimit dhe regjistrat e të gjitha llojeve që i përkasin periudhës së sipërpërmendur si dhe çdo e dhënë tjetër që do t'i shërbejë punës së Autoritetit.

Pas miratimit të VKM-së nr. 98/2017 Autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit përcaktojnë një program të përbashkët pune për kalimin e materialit arkivor, duke respektuar afatet e përcaktuara në ligj.

Fillimisht nga Institucionet u dërguan emrat e punonjësve dhe personave përgjegjës, që ushtrojnë detyrën për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit në arkivat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivës, të cilët do të jenë pjesë e grupeve të punës që do të bashkëpunojnë me Autoritetin gjatë procedurës së kalimit të dokumentacioni arkivor nën administrimin e Autoritetit.

ÇFARË FSHIHET

Fondi i Kundërzbulimit VS Fondi i Zbulimit



Në vijim të këtij procesi janë firmosur 3(tre) marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe Urdhri i përbashkët me:

- i. AIDSSH dhe Ministria e Punëve të Brendshme në datën 19.05.2017;
- ii. AIDSSH dhe Shërbimi Informativ Shtetëror në datën 26.06.2017;
- iii. AIDSSH dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në datën 05.05.2017.

AIDSSH-ja dhe Institucionet si MPB, SHISH dhe DPA kanë rënë dakord se do të bashkëpunojnë për të përmbushur detyrat ligjore veçanërisht në fushat e mëposhtme:

- a) Hartimin, miratimin dhe ndjekjen e zbatimit të programeve të përbashkëta të punës në përputhje me qëllimin e tyre;
- b) Hartimin e inventarëve dhe procesverbaleve të materialit arkivor, sipas parashikimeve të nenit 1 të VKM-së nr. 98/2017, nga çdo Institucion dorëzues të fondit arkivor;
- c) Caktimi i ambienteve, mjediseve të punës së grupit të Autoritetit;
- d) Hyrja në ambientet e fondruajtjes së arkivave të Institucioneve;
- e) Ruajtja dhe siguria fizike e ambienteve të mjediseve ku do të vendosi fondi arkivor;
- f) Raportimi periodik i grupeve të punës.

Grupet e punës të krijuara janë marrë me të gjithë procesin e kalimit në administrim të dokumentacionit.

Me firmosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit nga grupet e punës filloi puna për kalimin në administrim të Autoritetit të dokumentacionit arkivor të identifikuar, sipas parashikimeve të ligjit dhe të VKM-së.

Fondet arkivore të ish Sigurimit të Shtetit të identifikuar dhe të transferuara pranë AIDSSH për periudhën pas miratimit të VKM-së nr. 98/2017 deri më 31 Dhjetor 2017 sipas institucioneve të tyre burimore, janë si më poshtë vijon :

- i. Ministria e Punëve të Brendshme
- ii. Shërbimi Informativ Shtetëror
- iii. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

i. Ministria e Punëve të Brendshme

Në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë identifikuar fondet arkivore që i përkasin ish Sigurimit të Shtetit si më poshtë:

1. Fondi i dosjeve administrative
2. Fondi i dosjeve të rrjetit sekret
3. Fondi i dosjeve të përpunimeve

1. Fondi i dosjeve administrative Në këtë fond përfshihet dokumente për veprimtarinë e institucionit (ish MPB) si analiza vjetore, plane masash, përgjithësimet, informacione, letra, raporte, etj. Në pjesën më të madhe të tij Fondi është i klasifikuar. Nga ky fond janë deklasifikuar të gjitha vendimet e Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve.

Nga fondi i dosjeve administrative:

- Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit ka 8488 dosje. Këto ruhen në masën 40% në mikrofilm dhe origjinal. Mikrofilmimi është

bërë deri në vitin 1974.

- Drejtoria e Dytë e Sigurimit të Shtetit ka 860 dosje. Ruhet në mikrofilm dhe origjinal. Si fond është i mikrofilmuar në masën 20%.
- Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit ka 997 dosje deri në vitin 1975. Fondi ruhet në mikrofilm dhe origjinal.

2. Fondi i dosjeve të rrjetit sekret Ky fond përbëhet prej 1642 dosjesh të bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit. Jo të gjitha dosjet personale të tyre janë të shoqëruara me dosjet e tyre të punës.

Këto materiale arkivore janë të vendosura të kyçura dhe të bllokuara për llogari të AIDSSH në një ambient me Drejtorinë e I, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë.

3. Fondi i dosjeve të përpunimeve Ky fond përbëhet nga 104 dosje përpunimi të DPB Sarandë, 38 dosje drejtimi të DPB Vlorë dhe 16 fashikuj të DPB Berat. Ndërkohë janë të pa inventarizuara dosjet formularë (të përpunimit) të Matit, Fierit, Gjirokastrës (të cilat ndodhen në godinën e Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë); Librazhdi dhe Tepelena. Këto gjithsesi janë në numër të vogël dosjesh. Për dosjet e përpunimeve që i përkasin ish Degës së Punëve të Brendshme Sarandë, mund të thuhet nga një shikim i shpejtë, pasi janë të pa inventarizuara, që janë kryesisht në drejtim të zbulimit grek.

Fondet e mësipërme arkivore (1, 2, 3) janë të veçuara në një ambient të veçantë të Arkivit të Sistemit të MPB, të mbyllur dhe vulosur nga të dy

institucionet. Ka filluar marrja e tyre në dorëzim përmes verifikimit fizik nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme, në bazë të urdhrin nr. 71 datë 06.12.2017 të Autoritetit.

Deri tani ka përfunduar marrja e plotë në dorëzim e materialit dokumentar të mikrofilmuar:

- ✓ Drejtoria I: janë marrë në dorëzim 1250 mikrofilma të cilët janë verifikuar një për një dhe janë ballafaquar me listimin elektronik dhe është kontrolluar gjendja e tyre fizike.
- ✓ Drejtoria II: janë marrë në dorëzim 33 mikrofilma të cilët janë verifikuar një për një dhe janë ballafaquar me listimin elektronik dhe është kontrolluar gjendja e tyre fizike.
- ✓ Drejtoria III: janë marrë në dorëzim 967 mikrofilma të cilët janë verifikuar një për një dhe janë ballafaquar me listimin elektronik dhe është kontrolluar gjendja e tyre fizike.

Ky material arkivor përfshin vitet 1945-1974, i cili është transportuar, transferuar sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 45/2015, ligjit nr. 9154/2003 “Për arkivat”, VKM-së nr. 98/2017, Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis AIDSSH-së dhe MB, si dhe akteve të tjera nënligjore dhe është vendosur në zyrën e Fondit arkivor të AIDSSH-së.

4. Dokumentacioni arkivor i ish degëve të punëve të brendshme në rrethe nga viti 1945 – 1991, fondet bazë dhe ata shtesë.

Ky fond përfshin aktivitetin administrativ të ish degëve të punëve të brendshme nëpër rrethe me varësi të drejtpërdrejtë nga ish Ministria e Brendshme nga viti 1945 – 1991.

Për këtë fond arkivor jemi ende në pritje, pasi akoma nuk është nxjerrë sasia e dosjeve që gjenden në sektorët e sigurimit të secilës degë. Këto sektorë kanë material dokumentar të mirëfilltë krijuar nga ish – Sigurimi i Shtetit.

Ndërsa për pjesën tjetër të këtij fondi që nuk ka dokumentacion të mirëfilltë të ish Sigurimit të Shtetit është dakortësuar me grupin e punës të Arkivit të Sistemit në Ministrisë e Brendshme që të marrim fotokopje të këtyre materialeve arkivore.

Dosjet ruhen në objektin brenda Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë. Janë të vendosura në kuti, kutitë në rafte metalike dhe ruhen në kushte relativisht të mira. Dokumentacioni është i përpunuar nga ana tekniko-shkencore.

Ky fond është mbyllur dhe vulosur nga të dy institucionet, të gatshme për të filluar procesin e ndarjes, selesionimit dhe tërheqjes së pjesës sonë takuese.

5. Fondi i dosjeve hetimore e gjyqësore përbëhet nga **13968** dosje, të gjitha të inventarizuara në mënyrë elektronike (gjeneralitetet e personit dhe numri i dosjes). Këto janë dosje të personave të hetuar dhe dënuar gjatë periudhës së regjimit komunist me akuzat për veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar. Ky fond është i vendosur në ambient më vete, i ndarë nga pjesa tjetër e dokumentacionit arkivor. Dosjet janë vendosur në kuti sipas numrit rendor të tyre.

Fondi është mbyllur dhe vulosur nga të dy institucionet, të gatshme për të filluar procesin

e dorëzimit e të marrjen në dorëzim sipas legjislacionit të arkivës. Nga ky Fond është marrë në dorëzim dhe është transferuar në zyrën e Fondit pranë AIDSSH-së pjesa e mikrofilmuar e tij. *Afërsisht janë 29 mijë fletë mikrofilma të cilat janë verifikuar dhe janë ballafaquar me listimin elektronik si dhe është kontrolluar gjendja e tyre fizike. Transportimi dhe transferimi i tij është bërë sipas legjislacionit të arkivave.*

6. Fondi i dosjeve personale të punës të oficerëve

dhe nënoficerëve të sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme si dhe të punonjësve civilë e ilegalë përfshin periudhën që nga viti 1945 e në vazhdim. Numri i tyre është rreth 12000 dosje oficerësh, 16340 nënoficerësh, 950 ilegalë (punëtor operativ për periudhën 1945 – 1990) si dhe 520 dosje të punonjësve civilë, dosje të cilat jo të gjitha i përkasin fondit të ish-Sigurimit të Shtetit. Kështu, nuk ka një ndarje të dosjeve për personelin oficer, nënoficer rezervë ose ilegal të cilat i përkasin organeve të ish Sigurimit të Shtetit. Dosjet, nga verifikimi fizik në vend është parë se kanë numrin rendor, numrin arkivor dhe ndjekin një rend kronologjik që nga viti 1945 – 1990. Janë të arkivuara së bashku edhe me dosjet e personelit që ka shërbyer në sektorin e kufirit, në sektorin e policisë, etj.

Deri sa të merret një vendim përfundimtar dhe të bëhet ndarja e pjesës takuese të ish Sigurimit të këtij fondi arkivor i gjithë fondi është bllokuar dhe kyçur nga dy institucionet tona. Ndërkohë vazhdon puna me të sipas kërkesave të ndryshme.

13968 Dosje

përbëjnë Fondin e dosjeve hetimore e gjyqësore, të gjitha të inventarizuara në mënyrë elektronike (gjeneralitetet e personit dhe numri i dosjes). Këto janë dosje të personave të hetuar dhe dënuar gjatë periudhës së regjimit komunist me akuzat për veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.09.1991

7. Fondi me Nr. 140 i përbërë nga **6098** dosje operative të mikrofilmuara. Dosjet e tyre origjinale ose dosjet fizike janë në arkivin e SHISH-it. Këto janë dosje përpunimesh, dosje pune dhe personale të bashkëpunëtorëve. Emrat e personave të cilëve iu përkasin këto dosje janë të listuara elektronikisht.

Ky fond përbëhet gjithsej nga 12 470 fletë të mikrofilmuara të cilat janë marrë tërësisht në administrim. Këto janë verifikuar një për një dhe janë ballafaquar me listimin elektronik si dhe është kontrolluar gjendja e tyre fizike. Këto materiale arkivore janë transportuar e transferuar duke u vendosur në zyrën e Fondit arkivor të AIDSSH-së.

8. Dokumentet arkivore të krijuara nga Komisionit, i cili ka funksionuar sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, të ndryshuar si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

Dokumentet arkivore të krijuara nga ky Komision janë ruajtur edhe në arkivin e Ministrisë së Brendshme, sipas parashikimeve të nenit 16, të ligjit nr. 8043/1995, të ndryshuar. Dokumentet janë të pa inventarizuara dhe të pa përpunuara. Duke qenë se ky material arkivor ishte në këtë gjendje, fillimisht u punua nga Sektori i Ruajtjes së

Fondeve në zyrat e Ministrisë së Brendshme duke kryer një sistemim, ndarje dhe listim të dosjeve për efekt administrimi të mëtejshëm. Po kështu, rezultoi se, nga dokumentacioni arkivor i krijuar nga puna e këtij Komisioni nuk ka një data bazë të dhënash për të mundësuar verifikimin e shpejtë dhe të saktë për të kontrolluar nëse, zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike e kanë marrë apo jo certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, të cilat kanë funksionuar sipas ligjit nr. 8001/1995 dhe ligjit nr. 8043/1995, të ndryshuar.

Dokumentacioni u tërhoq dhe u transferua në ambientet e AIDSSH-së, sipas legjislacionit në fuqi dhe aktualisht janë të vendosura në zyrën e Ruajtjes së Fondit të AIDSSH-së.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh burimet njerëzore aktuale të Drejtorisë së Arkivit prej 3 punonjësish, dy Përgjegjëse Sektori dhe një specialist, fond ruajtës, Autoriteti vlerësoi domosdoshmërinë e ngritjes së grupit të punës, brenda Institucionit për inventarizimin, përpunimin, hartimin e listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor të krijuar nga Komisioni që ka funksionuar sipas ligjit nr. 8001/1995, të ndryshuar si dhe ligjit nr. 8043/1995. Njëkohësisht, domosdoshmëri për krijimin e grupit të punës është jo vetëm kërkesa e nenit 29, pika 4 e ligjit nr. 45/2015, por edhe rëndësia e procesit të verifikimit e subjekteve të parashikuara në ligj kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra.

Ka filluar puna për një listim elektronik të personave që janë verifikuar nga Komisioni i mëparshëm për të mundësuar verifikimin e shpejtë dhe të saktë të kontrollit paraprak nëse, zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike e kanë marrë apo jo certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, të cilat kanë funksionuar sipas ligjit nr. 8001/1995 dhe ligjit nr. 8043/1995.

9. Dokumente të tjera të ish-Sigurimit të Shtetit të ruajtura në mënyrë elektronike.

Në vijim të identifikimit të materialeve arkivore që i përkasin ish Sigurimit të Shtetit në Arkivin e Sistemit në MB janë identifikuar dhe disa fonde të pa inventarizuara në mënyrë elektronike. Këto janë fonde që përfshijnë dosje të reparteve ushtarake të kufirit, degëve të sigurimit të ushtrisë (DSU) dhe të disa reparteve ushtarake. Në këtë fazë që është ky proces nuk ka një numër total të dosjeve, i cili do të dalë pas përfundimit të inventarizimit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme dhe do të nxjerrë në pah atë pjesë të dokumentacionit i cili i takon ish-Sigurimit të Shtetit.

Aktualisht, jemi në pritje të ndarjes së këtij fondi nga grupi i Ministrisë së Brendshme.

10. Dokumente të tjera arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.

Janë identifikuar në ambientet e Fondit ku ruhet dokumentacioni me vlerë ruajtje të përhershme si vijon:

- ✓ Skedarë me kartela me të dhëna nga dosjet hetimore – gjyqësore;
- ✓ Tregues dhe katalogë alfabetikë me të dhëna nga dosjet hetimore – gjyqësore;

- ✓ Skedarë alfabetikë me kartela model nr. 1 të përpunimeve, sipas modelit të përcaktuar në “Rregulloren e Evidencës Operative” viti 1987.
- ✓ Kartela model nr. 2 RSI, sipas modelit të përcaktuar në “Rregulloren e Evidencës Operative” viti 1987.
- ✓ të sektorit të Degës së Punëve të Brendshme, Lushnjë.
- ✓ Regjistra për kontingjentet në përpunim;
- ✓ Libra të evidencës operative;
- ✓ Botime të Ministrisë së Punëve të Brendshme (botime artistike, studime monografike, historikë, etj.) për përdorim të brendshëm;
- ✓ Dosje formulare, personale dhe pune që i përkasin Sektorit të Sigurimit të Degës së Punëve të Brendshme Librazhd;
- ✓ Dosje formulare, personale dhe pune që i përkasin Sektorit të Sigurimit të Degës së Punëve të Brendshme Tepelenë.
- ✓ Regjistra të hyrje – daljeve të qytetarëve shqiptarë dhe të huaj në vendin tonë dhe anasjelltas.

Gjithë dokumentacioni i listuar është marrë në dorëzim sipas legjislacionit në fuqi, duke hartuar edhe procesverbalet përkatëse.

Për shkak të mungesës së ambienteve në AIDSSH për sistemimin e këtij dokumentacioni të identifikuar e të marrë në dorëzim ai është vendosur në një ambient më vete brenda godinës së Fondit të Përhershëm në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë, i cili është vënë në dispozicion të Institucionit tonë.

11. Materiale të tjera arkivore audiovizive. Grupet e punës së dy Institucioneve kanë identifikuar edhe materiale të tjera arkivore të ish-sigurimit të Shtetit. Këto janë materiale audiovizive të cilat nisur nga shënimet që kanë disa prej tyre, vlerësohen se i përkasin ish-Sigurimit të Shtetit. Në përmbajtje të tyre janë regjistrime të proceseve gjyqësore politike. Në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme nuk figuron ndonjë inventar i gjendjes ose numrit të tyre.

Aktualisht janë marrë masat të veçimit të tyre dhe të vendosjes në njëambient më vete, i cili është vënë në dispozicion të Institucionit. Ky fond është i kyçur dhe i gatshëm për të përpunuar dhe marrë në dorëzim. Procesi i zbardhjes së këtyre regjistrimeve kryhet me aparaturo të posaçme dhe nga persona të specializuar.

ii. Shërbimi Informativ Shtetëror

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që ishte në administrim të Shërbimit Informativ Shtetëror i identifikuar sipas parashikimeve të nenit 1 të VKM-së nr. 98/2017 ka kaluar në administrim të AIDSSH-së. Në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të cilat kanë kaluar në administrim të AIDSSH-së përfshihen Dosje bashkëpunëtorësh, Dosje përpunimi (2A, 2B), Dosje Drejtimi, Dosje Zbulim Autori dhe Dosje Kërkimi, Dosje Objekt i Rëndësisë së Veçantë, Fashikuj të ndryshëm me emra, Dosje Agjenturore, Dosje me Probleme të Centralizuar dhe Dosje të tjera Operative, Regjistra të ndryshëm, Procesverbale, lista veçimi,

statistika, kartela, evidenca, libra, studime, tema, përgjithësime, novela, informacione, analiza, plane, akte normative, kompjuterët me te dhënat e dokumenteve të Ish Sigurimit të Shtetit, si dhe fondi i mikrofilmimit. Po në këtë fond janë përfshirë edhe dokumentacioni arkivor që disponon arkiva e SHISH për Komisionin që ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 8001/1995, dhe ligjit nr. 8043/1995 të ndryshuar.

Dokumentacioni i administruar nga SHISH është i klasifikuar “sekret shtetëror” dhe është trajtuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar ”sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Dorëzimi i dokumentacionit të administruar nga SHISH është bërë nga personi përgjegjës, qe ushtron detyrën për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të këtij fondi, në arkivin e Shërbimit Informativ të Shtetit në prezence të eprorit të drejtpërdrejtë dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim janë përfunduar. Me Urdhrin nr. 51, datë 17.07.2017 “Për administrimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit marrë në dorëzim nga SHISH”, është caktuar Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit, pranë Drejtorisë së Arkivës së AIDSSH-së për të administruar të gjithë dokumentacionin arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit që kalon nën administrimin e Autoritetit nga Shërbimi Informativ Shtetëror.

Po kështu, punonjësit e Sektorit të Ruajtjes së Fondeve kanë asistuar gjithë procesin e transferimit të këtij dokumentacioni.

Procedurat për dorëzimin e mjeteve bartëse janë trajtuar me procedurë të veçantë dhe teknikë të fushës përkatëse. Kalimi i të dhënave që ndodhen në tre kompjuterët që mbartin materiale të ish-Sigurimit të Shtetit dhe Komisioni i ngritur për këtë qëllim po vijon procedurat përkatëse për kalimin e këtyre të dhënave.

Aktualisht i gjithë fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që ka qenë pranë SHISH-it ka kaluar në administrim të Autoritetit. Ky fond për shkak të mungesë së ambienteve të AIDSSH-së është vendosur në një mjedis pune të përshtatshëm për shfrytëzimin e dokumentacionit arkivor të Ish-Sigurimit të Shtetit, deri në transferimin përfundimtar. Ambienti ku është vendosur i gjithë fondi arkivor dhe ku bëhet shfrytëzimi i tij është vënë në dispozicion të AIDSSH-së dhe në të hyjnë vetëm përfaqësues të AIDSSH-së. Shërbimi Informativ i Shtetit merr masat e sigurisë për ruajtjen dhe sigurinë fizike të këtij ambienti ku është vendosur fondi arkivor, i marrë në dorëzim nga administruesi i fondit të Autoritetit. Sipas Urdhrit të përbashkët të dy Institucioneve është rënë dakort që Shërbimi Informativ i Shtetit lejon hyrjen pa kufizim të përfaqësuesve të Autoritetit, të cilëve iu është njohur e drejta e aksesit për hyrje-dalje, në ambientet e përcaktuara për shfrytëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Punonjësit e Autoritetit, të cilët kanë të drejtën e aksesit për hyrje-dalje në zonat e sigurisë të Klasit të Parë respektojnë regjimin e hyrje-daljeve të vendosur me akte të brendshme të Drejtorit të SHISH.

iii. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Në Arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit janë identifikuar fondet arkivore, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2015. Autoriteti, në zbatimin e detyrave të tij, sipas ligjit me të cilin funksionon, mund të kërkojë nga organet përkatëse informacion për llojin, përmbajtjen dhe vendin e ruajtjes së dokumenteve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera politiko-shoqërore që kanë vepruar gjatë periudhës 2 korrik 1991 deri në 30.9.1991.

Ligji ka parashikuar në nenin 14 të tij se, Autoriteti, sipas nevojës, mund të kërkojë të shqyrtojë dokumentet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera politiko-shoqërore. Me kërkesën e tij, Autoritetit i dorëzohen dublikata të këtyre dokumenteve kur këto kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit dhe i nevojiten për përmbushjen e funksioneve të tij.

Autoriteti merr dublikata edhe për dokumentet që janë krijuar nëpërmjet bashkë-veprimit me ish-Sigurimin e Shtetit, me nxitjen apo në zbatim të urdhrave dhe udhëzimeve të tij.

1. Në vijim të punës së Autoritetit është marrë në dorëzim dokumentacioni arkivor që gjendej në Sektorin e ish Arkivit të KQPPSH i cili përbëhej nga materiale tepër sekret të ardhura nga Drejtoria I, II dhe III.

Materiali ishte i papërpunuar, por për arsye të rëndësisë së informacioneve që kishte ky fond u vendos që të merret duke u kontrolluar fletë për fletë, sipas parashikimeve të nenit 7 dhe 22 të Normave Teknike Profesionale dhe metodologjike

të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kështu, nga Sektori i Ruajtjes së Fondeve u nxor gjendja faktike. Ky material arkivor u sistemua në 18 kuti dhe u plotësuan me tërë elementët e domosdoshëm sipas Dispozitave. Këto përmbajnë 150 dosje dhe kanë në total 18599 fletë, si dhe plus 85 fletë kopje të tepërta të materialeve, të cilat janë këqyruar një për një. Ky material arkivor është me nivel klasifikimi dhe është trajtuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 189 datë 04.03.2015 “Për sigurimin fizik të Informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s BE-së Shteteve dhe Organizatave të tjera Kombëtare”.

Këto dosje janë marrë në dorëzim dhe janë sistemuar në zyrën e Ruajtjes së Fondit të AIDSSH-së. Transportimi i tyre është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Fondi arkivor “Hetuesia 1983-1993”, duke përjashtuar periudhën pas datës periudhën pas datës 30.09.1991.

Grupet e punës në zbatim të Marrëveshjes me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave si dhe në përgjigje të shkresës sonë nr. 529 prot., datë 23.10.2017 në të cilën specifikohet kalimi në administrim i fondit “Hetuesia 1983 – 1993”, fond i listuar dhe i identifikuar njëkohësisht edhe në përgjigjen e DPA-së, negociuan për kalimin në administrim të këtij fondi nga DPA-ja tek AIDSSH-ja. Sipas takimit të grupeve të punës së dy institucioneve në prezencë të anëtarit të Autoritetit, zotit Marenglen Kasmi ka rezultuar se:

- Fondi “Hetuesia 1983-1993” është i papërpunuar dhe ruhet në një ambient të veçantë.
- Dokumentet, sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i punës së DPA-së, janë përafërsisht 65 metër linearë.
- Nga ana e grupit të punës së DPA-së është bërë një ndarje e dokumentacionit sipas viteve.
- Nga grupi i punës së AIDSSH-së u konstatua që ka dokumentacion i cili i përket periudhës kur ky fond ishte pjesë e Arkivit të Sistemit të MPB-së.
- Fondi ka nevojë për përpunim, pasi në këtë fond përfshihen dhe ka dokumente të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit sipas parashikimeve në nenin 2 të ligjit nr. 45/2015 dhe të pikës 1 të VKM-së nr. 98/2017, pra nuk plotësojnë kuadrin ligjor për të kaluar në administrim të Autoritetit.

Në këto kushte ngelet që procesi i kalimit në administrim të këtij fondi nga DPA-ja te AIDSSDH-ja të kryhet, pas verifikimit në vend të fondit, llojit të dokumentacionit që përmban si dhe nivelin e shkallës së përpunimit të tij.

3. Fondet dublikatë të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, administruar pranë AIDSSH-së.

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 45/2015 të VKM-së nr. 98/2017 si dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis dy Institucioneve ka përfunduar procesi i dorëzimit dhe marrjes në dorëzim nga AIDSSH-ja të fondeve dublikatë, të cilat janë:

- ✓ Lista e anëtarëve të KQ, deputetëve dhe

anëtarëve të PPSH, etj., nga legjislatura e parë deri në legjislaturën e njëmbëdhjetë.

- ✓ Dokumentacioni që lidhet me platformat e punës operative të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Fondi 14/AP OU (Organet Udhëheqëse) dhe janë të viteve 1953, 1954, 1958, 1959, 1960 dhe 1961; vitet 1962, 1963, 1965, 1970, 1985, 1988, 1990, 1991.

Fondet e mësipërme ruhen në zyrën e ruajtjes së Fondit të AIDSSH-së.

4. Dokumentet arkivore për Komisionin, i cili ka funksionuar sipas ligjit nr. 8043/1995, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8001/1995.

Ky fond përmban gjithë dokumentacionin e korrespondencës midis DPA-së dhe Komisionit që ka funksionuar sipas ligjit nr. 8043/1995 dhe ligjit nr. 8001/1995. Gjithë dokumentacioni është marrë në dorëzim dhe gjendet i administruar pranë zyrës së Ruajtjes së Fondeve të AIDSSH-së.

iv. Deklasifikimi i dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit

Dokumentacioni arkivor i krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit i administruar me nivelin e klasifikimit “sekret shtetëror” është trajtuar sipas Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Ndërsa dokumentacioni tjetër, i cili nuk ka patur nivel klasifikimi është trajtuar sipas Ligjit nr. 9154,

datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Me Urdhrin nr. 12, datë 10.02.2017 “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të klasifikuar sekret shtetëror në AIDSSH” është krijuar Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili pasi shyrton informacionin e klasifikuar për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e tij vendos për: i) deklasifikimin e dokumentit, duke e kthyer në një dokument të zakonshëm; ii) uljen e nivelit të klasifikimit (zhvlerësimin); iii) ruajtjen e nivelit të klasifikimit të përcaktuar në listë, sipas afatit të ruajtjes dhe iv) përjashtimin nga deklasifikimi dhe zhvlerësimi, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr. 8457/1999, të ndryshuar.

Me ndryshimin e VKM-së nr. 124, datë 15.03.2001 “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave” dhe daljen e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” nga ana e Autoritetit u morën menjëherë masat për ndryshimin e Urdhrit të KDZH-së, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM-në 662/2017 dhe për këtë qëllim ka dalë Urdhri i ri mbi bazën e të cilit funksionin KDZH-ja në përbërje të saj me 7 anëtarë.

KDZH-ja për vitin 2017 ka marrë 27 vendime deklasifikimi, më anë të së cilave janë deklasifikuar në total 102 dosje që i përkasin fondit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit.

4.2 Drejtoria e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik

Kjo Drejtori, sipas strukturës përbëhet nga Sektori i Zhvillimit Teknologjik dhe nga Sektori i Sigurisë Fizike dhe qarkullimit të dokumenteve të klasifikuara. Sipas organikës ka në përbërje të saj Drejtorin, Përgjegjësën e Sektorit dhe tre specialist, për vitin 2017 ka funksionuar vetëm me një specialiste IT, të Sektorit të Zhvillimit Teknologjik.

Në funksion të zbatimit të ligjit nr. 45/2015, autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, edhe legjisllacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit gjatë veprimtarisë së tij është ndeshur me dokumente dhe informacione të klasifikuara dhe ka vepruar në përputhje me legjisllacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, sipas rastit dhe nivelit të klasifikimit.

Me Autorizimin nr. 895/1 prot., datë 10.02.2017 të Kryeministrit “Për të drejtën e klasifikimit origjinal”, Kryetare e Autoritetit është autorizuar të bëjë klasifikimin origjinal të informacionit “sekret shtetëror”, që prodhon Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjorë në fuqi.

Duke patur parasysh se mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet

ndër të tjera edhe nga parimet e mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, plotësimi i kuadrit ligjor të brendshëm të Institucionit që ka të bëjë me mënyrën e ruajtjes fizike të dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit ishte një nga prioritetet për vitin e parë të punës.

1. Siguria e ambienteve, e informacionit dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit me nivel klasifikimi, sipas legjislacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”

1.1. Me Urdhrin e brendshëm nr. 35, datë 26.04.2017 “Për caktimin e strukturës së sigurisë në AIDSSH” është ngritur struktura e sigurisë së Institucionit në përbërje të së cilës janë caktuar :

i) Drejtori i Drejtorisë së Informacionit; ii) Përgjegjësi i Sektorit të Kërkesave të Institucioneve në Drejtorinë e Informacionit; iii) Specialist i Fondit të Ruajtjes në Drejtorinë e Arkivit. Nëpunësit e strukturës së sigurisë janë caktuar pika kontakti, për organizimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e të gjitha aspekteve ligjore dhe nënligjore për punën me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, në kuadër të sigurisë së sistemit të arkivës dhe godinën ku ushtron veprimtarinë AIDSSH-ja.

Struktura e sigurisë është ngritur me qëllim zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar dhe si kërkesë e

pikës 10 të VKM-së nr. 189, datë 04.03.2015, “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të Natos-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

1.2 Me Urdhrin e brendshëm nr. 34, datë 26.04.2017 “Për ndarjen e zonave të sigurisë në Autoritet” është bërë ndarja e zonave të sigurisë në të cilën është përcaktuar se, informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, krijohet, regjistrohet, qarkullohet, shumëfishohet, shfrytëzohet, ruhet dhe shkatërrohet në zyrat dhe mjediset e punës të Autoritetit, në përputhje me ndarjen e zonave të sigurisë. Këto zona të sigurisë janë kategorizuar në “Zonë e Klasit të Parë”, “Zonë e Klasit të Dytë” dhe “Zonë Administrative”.

Urdhri ka dalë me qëllim ndarjen e zonave të sigurisë dhe sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar dhe në zbatim të pikës 9, të Kreu I, të VKM nr. 189, datë 04.03.2015, “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

1.3 Kryetarja e Autoritetit në datën 26.04.2017 ka Miratuar Planin e Masave “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar në Autoritet”. Autoriteti për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, prodhon dhe administron informacione të klasifikuara “sekret shtetëror”, të niveleve nga niveli më i ulët i klasifikimit “I Kufizuar” deri në nivelin më të lartë të klasifikimit “Tepër sekret”. Këto kategori informacionesh trajtohen vetëm në Zonat e Sigurisë. Me qëllim për të garantuar sigurinë e informacioneve të klasifikuara dhe të ambienteve në të cilat prodhohen e administrohen kategoritë e lartpërmendura

të këtyre informacioneve është hartuar Plani i Masave nga strukturat përgjegjëse.

Duke patur parasysh faktin se, aktualisht AIDSSH-ja ushtron veprimtarinë e saj në ambientet e vëna në dispozicion nga Garda e Republikës së Shqipërisë, pjesë e Planit të Masave për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar është “Skema e Sigurisë Fizike të këtij ambienti”.

Në një kohë tjetër kur Institucioni do të ushtroj aktivitetin në Godinën e saj sipas VKM-së nr. 935/2017 atëherë pjesë e Planit të Masave do të jetë dhe “Skema e Sigurisë Fizike të Godinës së re të Autoritetit”.

1.4 Plan–Evakuimi “Për Informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që administrohet në AIDSSH” është përgatitur nga strukturat përgjegjëse dhe më pas është miratuar në mbledhjen e Autoritetit. Ky plan është hartuar bazuar në VKM-së nr. 189, datë 4.3.2015, “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, kreu i V-të, pika 1 dhe 2, të tij. Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit, si çdo institucion tjetër që punon me informacion të klasifikuar, sipas parashikimit të VKM-së nr. 189/2015 ka detyrimin të përgatis dhe miratojë planin e detajuar të evakuimit të informacionit të klasifikuar, “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

Duke iu referuar pikës 5, të kreut V, të VKM-së nr. 189/2015 transportimi i informacionit të klasifikuar

“Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe pajisjeve, nga vendi i grumbullimit për në vendet e caktuara për ruajtje, bëhet me mjetet e planifikuara dhe i shoqëruar me roje të armatosura. Për Institucionet që nuk kanë mundësi shoqërimi me roje të armatosura bashkëpunohet me Ministrinë e Brendshme.

Në këtë kuadër është kërkuar bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, konkretisht me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, duke dërguar zyrtarisht Plan-Evakuimin të përgatitur për bashkë firmosje nga Drejtuesi i Policisë së Shtetit.

Aktualisht, ky Plan-Evakuimi nuk është firmosur nga drejtuesit e Policisë së Shtetit, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur së fundmi në këtë Institucion. Mbetet për të finalizuar këtë proces në vitin e ardhshëm të punës së AIDSSH-së.

1.5 Siguria fizike e dokumenteve arkivore në vend ruajtje dhe përgjegjësia për materialin arkivor kaluar në administrim të AIDSSH-së.

Me Urdhrin nr. 56, datë 21.08.2017 “Për sigurimin fizik të dokumenteve arkivore të Ish-Sigurimit të Shtetit në AIDSSH” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar mënyra dhe mjetet e transportimit të dokumenteve arkivore të Ish-Sigurimit të Shtetit, regjistrimi i tyre, ruajtja në ambientin e vend ruajtjes së fondeve arkivore, regjimi i hyrje daljeve në fond dhe sigurimi i fizik i ambientit.

Aktualisht, për shkak të mungesës së ambienteve Fondi arkivor i AIDSSH-së ndodhet në vend ruajtje

të ndryshme: i) pranë ambienteve të vëna në dispozicion nga SHISH; ii) pranë ambienteve të vëna në dispozicion nga MB dhe iii) në zyrat ku ushtron veprimtarinë Autoriteti, pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë. Janë marrë masat për ndarjen e përgjegjësisë për materialin arkivor kaluar në administrim të Institucionit.

- ✓ Fondi i cili ndodhet në ambientet qe na ka vënë në dispozicion SHISH është në administrim të Përgjegjësës së Sektorit të Përpunimit. Për këtë qëllim ka dalë dhe Urdhri nr. 51, datë 17.07.2017 “Për administrimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit marrë në dorëzim nga SHISH”
- ✓ Fondi, i cili ndodhet në ambientet e vëna në dispozicion nga Ministria e Brendshme është në administrim të Përgjegjësës së Sektorit të Ruajtjes së Fondeve dhe fondruajtësit, pjesë e grupeve të punës, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit me këtë Institucion.
- ✓ Ndërsa i përket dokumentacionit tjetër arkivor marrë në dorëzim dhe administruar pranë zyrave të AIDSSH-, sipas strukturës dhe përshkrimit të punës ato janë në administrim të specialistit të Ruajtjes së Fondeve.

1.6 Me Urdhri nr. 60, datë 01.11.2017 “Për krijimin e Komisionit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH” është krijuar Komisioni për Shqyrtimin e Informacionit të klasifikuar, i cili shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon Institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli. Komisioni është ngritur në mbështetje ligjit

nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar, “sekret shtetëror””, të ndryshuar dhe të VKM-së nr. 123, datë 15.03.2001, “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”.

Sipas propozimit të Komisionit të Shqyrtimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” të AIDSSH-së është miratuar “Lista e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror” me Urdhri nr. 61, datë 02.11.2017.

2. Zhvillimi teknologjik

Në kuadër të detyrave që Rregullorja e Brendshme ka parashikuar për Sektorin e Zhvillimit Teknologjik si vit i parë i punës fillimisht është bërë pajisja e të gjithë punonjësve të AIDSSH me e-mail zyrtar në domain-in: autoritetidosjeve.gov.al. Konfigurim i e-mail-it zyrtar në të gjithë kompjuterat.

Me qëllim pasqyrimin dhe mundësinë e kontaktimit të AIDSSH në Internet, është krijuar faqja zyrtare e institucionit tonë. Adresa e faqes është www.autoritetidosjeve.gov.al në serverat e AKSHI-it. Faqja është e paraqitur në mënyrë të thjeshtë duke pasur një strukturim nëpërmjet menuve dhe nënmenuve. Janë pasqyruar në të informacionet e përgjithshme mbi AIDSSH, anëtarët e Autoritetit, kuadri ligjor, të fushë së zbatimit por edhe ligje të tjera ndihmëse, si dhe aktet nën ligjore. Ligjet, aktet nënligjore janë të gjitha në versione të shkarkueshme. Gjithashtu janë pasqyruar informacione rreth regjistrimit të

Fondi - Ministria e Punëve të Brendshme

Dosje fizike

90.345

FONDI I DOSJEVE
ADMINISTRATIVE

14.000

FONDI I DOSJEVE
HETIMORE – GJYQËSORE

15.000

FONDI I DOSJEVE TË
PERSONELIT
TË ISH MPB

1.642

FONDI I DOSJEVE
TË RRJETIT SEKRET

200

FONDI MEZINI

12.470

FONDI I DOSJEVE
OPERATIVE
(FLETE XHAKETINA)

158

FONDI I DOSJEVE
TË PËRPUNIMIT

113

KATALOGË
ALFABETIKË

21.000

KARTELAT MODEL 1
(COPE KARTELA)

14.700

KARTELA ME TË
DHËNAT NGA DOSJET
HETIMORE-GJYQËSORE
(COPE KARTELA)

njoftimeve por edhe mbi aktivitetet e institucionit tonë dhe materialeve të përgatitura nga stafi. Faqja përditësohet, kontrollohet dhe mirëmbahet nga specialisti TI-së.

Për pajisjet elektronike në pronësi të Institucionit, donacion nga Ambasada Daneze, Ambasada Gjermane dhe OSBE është bërë vlerësim i tyre, formatim i tyre, instalim programesh. Është instaluar e gjithë infrastruktura IT, realizuar lidhja në rrjet e tyre.

4.3 Informimi i subjekteve për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Ligji nr. 45/2015 parashikon se çdo person ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti të informohet nëse në dokumentet e administruara ka informacione për personin e tij dhe t'i marrë këto informacione, kur ka të tilla, sipas këtij ligji. Autoritetet publike dhe subjektet e tjera, të parashikuara nga ky ligj, kanë akses te dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm për atë që lejohet nga ligji. Autoriteti vë në dispozicion të autoriteteve shtetërore përkatëse çdo informacion të siguruar gjatë veprimtarisë së tij, kur kjo kërkohet për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale.

Një nga përgjegjësitë e Autoritetit, sipas nenit 10 të ligjit nr. 45/2015 është dhënia e informacioneve e të njoftimeve mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe

dorëzimin e tyre për kërkuarët.

Ligji parashikon në tërësinë e tij garantimin e të drejtës për informim për personat për të cilët ish Sigurimi i Shtetit ka mbledhur të dhëna; bashkëpunëtorët e ish Sigurimit të Shtetit, të favorizuarit, rrethin e trashëgimtarëve të këtyre të fundit, institucionet, të interesuarit për qëllime hulumtuese, historike e të rivlerësimit politik dhe median. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara sipas subjektit kërkuar, duke garantuar, për çdo rast, të drejtën e jetës private të të tretëve, sipas vlerësimit të interesave të ligjshëm.

Ligji nr. 45/2015, ligji nr. 9877/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, Rregullorja e brendshme e Institucionit, miratuar me Vendim të Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017, Rregullorja “Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 25, datë 25.05.2017, Urdhri Nr. 10, datë 30.01.2017 “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale për informim pranë Autoritetit” dhe Urdhri Nr. 11, datë 30.01.2017 “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave për informimin e institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe personave privatë”, të miratuara me Vendim të Autoritetit janë bazë për procesin e informimit të subjekteve kërkuar që kërkojnë informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Autoriteti për vitin 2017 ka marrë 48 vendime me objekt verifikimin e figurave të zyrtarëve para emërimit apo ngritjes në detyrë, apo të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për deputet në kuadër të transparencës së fushatës zgjedhore, sipas kërkesave përkatëse. Në kuadër të trajtimit

të kërkesave individuale, 280 përgjigje janë legjitimuar nga Autoriteti për kërkesat individuale dhe më pas ka vijuar puna për vazhdimin e procedurës deri në përmbylljen e saj, sipas objektit të kërkesave të paraqitura.

Formularët e Aplikimit (modelet), për të gjitha kategoritë e kërkuësve, të miratuara në mbledhjet e Autoritetit lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme nga subjektet e interesuara. Me qëllimin e vetëm për të shfrytëzuar çdo mundësi për të sjellë ligjin organik nr. 45/2015, në vëmendje të çdo subjekti kërkuës, në përmbajtje të formularëve janë cituar dispozitat ligjore përkatëse nga buron detyrimi dhe përgjegjësia për informim, verifikim dhe shqyrtimin e kërkesës, në funksion të saktësisht dhe lehtësisht të procedurave që duhet të ndiqen nga kërkuësit.

Ecuria e procesit të kërkesave të paraqitura nga subjekte të interesuar, sipas objektit të kërkesës dhe procedura e brendshme Institucionale.

Me regjistrimin e kërkesës për informim dhe njohjen e anëtarëve të Autoritetit ajo përcillet për trajtim Drejtorisë së Informacionit e cila:

1-Përgatit praktikën përkatëse, ku përfshihet;

- a) Relacioni mbi bazën e objektit të kërkesave të paraqitura dhe procedurave të përfunduara, së bashku me materialin mbështetës,
- b) Projekt/vendimin sipas rastit të trajtimit dhe shqyrtimit të kërkesave (kryesisht për kërkesat e paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritet publike),
- c) Dokumentacionin përkatës provues, për procesin

e verifikimit apo gjetjes së dokumentacionit sipas objektit dhe legjitimitetit të kërkesës, të dërguar nga Sektorët e përfshirë në Drejtorinë e Arkivit.

- d) Në të gjitha rastet, kopje e praktikës së krijuar nga Drejtoria e Informacionit, i është venë në dispozicion Anëtarëve të Autoritetit, në funksion të zhvillimit të procedurave për mbledhjet e Autoritetit.

2-Në funksion të vendimmarrjes së Autoritetit, pas çdo mbledhje të radhës;

- a) Menjëherë i ka përcjellë Drejtorisë së Arkivit, të dhënat ekzistuese në Formularin e Aplikimit sipas objektit të kërkesës dhe llojit të saj, për vijimin e procedurave të verifikimit dhe gjetjes së dokumentacionit,
- b) Menjëherë ka përgatitur Vendimin përkatës në formatin dhe përmbajtjen e duhur, i cili firmoset rregullisht nga anëtarët e Autoritetit,
- c) Menjëherë ka përgatitur kthimin e përgjigjes mbi bazën e vendimmarrjes së Autoritetit,
- d) Ka ndjekur dinamikën e përpunimit të dokumentacionit në tërë komponentët e tij, si proces voluminoz dhe delikat

Sa më sipër, Drejtoria e Informacionit pasi vihet në dijeni për kërkesat e paraqitura, nga persona të interesuar, institucionet kushtetuese, autoritetet publike, subjektet zgjedhore, studiues/media, ka krijuar lehtësitë e duhura në ndihmë të kërkuësit, në funksion të paraqitjes korrekte të kërkesës si në formë dhe në përmbajtje, njëherazi ka treguar maturi dhe profesionalizëm gjatë zhvillimit të procedurave të trajtimit të kërkesave, duke mos

u bërë asnjëherë shkak për pengesa në zvarritjen e procedurave, në mënyrë që i gjithë procesi të jetë transparent dhe me integritet, duke zbatuar pikë së pari kuadrin ligjor në fuqi. Është punuar me kujdes në ndihmën ndaj subjekteve kërkuese, veçanërisht individëve që në hartimin e kërkesës, nëpërmjet ndërtimit të një fryme mirëbesimi nëpërmjet bashkëbisedimit paraprak.

1. Dinamikat e procesit të informimit të individëve, sipas objektit të kërkesës të paraqitur të trajtuar nga Autoriteti.

Ligji funksional, në Seksionin nr. 1 të tij parashikon të drejtën e informimit për kërkues individë:

- ✓ E drejta për informim e të prekurve, palëve të treta, bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të favorizuarve;
- ✓ E drejta për informim e të afërmeve të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ E drejta për informim e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit;

Mbi bazën e kuadrin ligjor janë trajtuar, legjitimuar dhe zhvilluar rast pas rasti kërkesat e paraqitura nga personat e interesuar sipas objektit përkatës.

Për vitin 2017, Drejtoria e Informacionit ka zhvilluar procedurat ligjore **për rreth 280 (dyqind e tetëdhjetë) kërkesa individuale**, të paraqitura nga subjekte individë në cilësinë e personave të prekur dhe palëve të treta, në cilësinë e të afërmeve të të vdekurve dhe të zhdukurve, në cilësinë e bashkëpunëtorëve apo të favorizuarve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Procesi ka kaluar në këto faza,

Faza e parë-Përgatitja e akteve për kërkesat e reja të paraqitura në Autoritet:

Dhënia e asistencës kërkuesit në plotësimin e Formularit të Aplikimit si në formë dhe përmbajtje, në funksion të përgatitjes së akteve që shërbejnë për mbledhjen e Autoritetit dhe krijimin e lehtësirave në vijueshmërinë e procesit të mëtejshëm.

Mbi bazën e dokumentacionit të administruar, i njohur paraprakisht nga anëtarët dhe i shoqëruar me shënime ose vërejtje përkatëse nëse ka, Drejtoria e Informacionit e verifikon atë nga ana formale dhe përgatit aktet (relacion, materiale mbështetëse) në funksion të trajtimit dhe shqyrtimit të kërkesës në mbledhjen e Autoritetit, për legjitimitetin e saj,

Nëse kërkesa rezulton me të meta dhe mangësi, e cilësuar si e tillë në mbledhjen e Autoritetit, komunikon me subjektet, për plotësimin e mangësive në dokumentacionin përkatës brenda një afati të arsyeshëm, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, por në asnjë rast refuzimin e procedurës për këtë shkak pa bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme dhe shteruese.

Pas legjitimitetit të kërkesës nga Autoriteti, Drejtoria e Informacionit ka përcjell menjëherë (për çdo rast jo më vonë se dy ditë) fillimisht institucioneve përkatëse që dispononin dokumentacionin e kërkuar, MPB, SHISH, DPA, Ministrisë Mbrojtjes dhe më pas Drejtorisë së Arkivit Këtu, të dhënat me gjeneralitetet e plotësuara në Formularin e Aplikimit, sipas objektit të kërkesës, në funksion të identifikimit dhe mbledhjes së dokumentacionit për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

Mbi bazën e dokumentacionit të evidentuar nga institucionet e sipërcituara dhe në vijim nga Drejtoria e Arkivit dhe administruar nga Drejtoria e Informacionit, në rastet kur nga rezultati i verifikimit nuk disponohen dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, atëherë Drejtoria e Informacionit ka përgatitur aktet (relacionin, materialet mbështetëse, kthimin e përgjigjes) në çdo rast jo më vonë se dy ditë, në funksion të zhvillimit dhe vendimmarrjes së Autoritetit, për përmbylljen e procedurës.

Faza e dytë-Procedurat dhe përgatitja e akteve për rastet kur evidentohen dosje/fashikuj regjistruar etj, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Së pari, në rastet kur nga rezultati i verifikimit të objektit të kërkesave individuale identifikohet se disponohen dokumente, dosje (dosje formulare, dosje personale, dosje të punës, dosje hetimore, dosje gjyqësore) fashikuj, fletë regjistri për bashkëpunëtorët, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të bëra prezent Autoritetit (anëtarëve) dhe të vena në dispozicion nga Sektori i Ruajtjes së Fondeve, pasi më parë është kryer procesi i de klasifikimit të këtyre dosjeve, me vendim të posaçëm nga mbledhja e anëtarëve nën përkujdesjen, mbikëqyrjen dhe shoqërimin e të cilëve dokumentacioni ka ardhur në institucion, atëherë Drejtoria e Informacionit pas disponimit të tyre fillon procedurën e renditjes, përpunimit dhe sistemimit të tyre.

Së dyti, gjithnjë me kërkesë dhe miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, nëpërmjet specialistit të Sektorit të Digjitalizimit, në më të shumtën e rasteve ka kryer procedurën e dixhitalizimit të dokumentacionit përkatës (dosje/fashikuj) etj., kjo

për dy qëllime, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj publikut, si dhe të mbrojtjes së dokumentacionit (fondit) nga dëmtimi i mëtejshëm, nga përdorimi i shumëfishtë dhe keqpërdorimi, veçanërisht në dosjet hetimore gjyqësore me shumë emra, në të cilat dhe procesi i anonimizimit është më i panevojshëm, pasi këto dosje janë të njohura nga të interesuarit në vijimësi dhe ky dokumentacion ka qenë publik në një proces gjyqësor të zhvilluar publikisht.

Së treti, Drejtoria e Informacionit nëpërmjet stafit të vet ka kryer në mënyrë korrekte dhe me cilësi procesin e anonimizimit të dokumentacionit përkatës, sipas llojit të dokumentacionit të administruar nga ana jonë, proces i cili merr kohë relativisht të gjatë dhe për të cilin nevojitet ndihmë dhe shumë për të bërë, qoftë për trajnimin e stafit dhe veçanërisht për përcaktimin e kriterëve të qarta dhe standardizimin e këtij procesi, deri më tani më delikati pas atij të de kodifikimit të bashkëpunëtorëve.

Së katërti, pas procesit të dixhitalizimit të dokumentacionit përkatës, në vijimësi është komunikuar me kërkuesin për njohjen me dokumentacionin origjinal, duke i krijuar kushtet e nevojshme ndonëse në kushte të vështira deri edhe në lirim të posteve të punës së personelit, për njohjen e kërkuesit me dokumentacionin e administruar nga Autoriteti, në kushte të rrepta mbikëqyrjeje dhe asistence në këtë proces.

Së pesti, mbi bazën e kërkesës së kërkuesit (shprehur në procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit rast pas rasti) është bërë e mundur vënia në dispozicion dhe dhënia e dokumentacionit përkatës kërkuesit (duke marrë

kopje apo publikatë të dokumentacionit që ndodhet në këto dosje), sipas objektit të kërkesës së tyre, gjithnjë, pasi ishte kryer më parë procesi i anonimizimit.

Sa më sipër, një nga parimet që udhëhiqet Autoriteti gjatë ushtrimit të detyrave funksionale që i ngarkon Ligji 45/2015, por jo vetëm, është dhe mbrojtja e të drejtës për jetën private dhe të dhënave personale. Në këtë kuadër janë marrë masa, për kufizimin pjesërisht të të drejtës për informim të kërkuarit, duke marrë në konsideratë Ligjin nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*. Gjithsesi kur në dokumentacion arkivor të administruar nga ana jonë gjatë procesit të anonimizimit kemi gjetur të dhëna komprometuese, diskredituese mbi cilësitë dhe personalitetin, si dhe për shëndetin dhe jetën seksuale të kërkuarit apo personave të tjerë, ato janë bërë të palexueshme për kërkuarin.

Në rastet kur nga përmbajtja e dokumentacionit në dispozicion, janë gjetur të dhëna se kërkuari ose i afërmi i tij, për të cilin është bërë kërkesa, ka rezultuar (konstatuar) informacion *“i padëshiruar”* si p.sh. bashkëpunëtor apo cilësi tjetër, gjithnjë me dijeninë dhe miratimin e anëtarëve në aplikim të ligjit dhe rregullores në mënyrë krijuese dhe me procedurë fleksibël, i janë bërë të ditur kërkuarit të drejtat ligjore për njohje, marrje publikatash dhe marrje përgjigje me shkrim. Kryesisht kemi proceduar me njohjen formale dhe verbale duke dokumentuar veprimtarinë tonë dhe shfaqjen e vullnetit (dëshirën) e kërkuarit për ndërprerjen e verifikimit të mëtejshëm, dhe heqjen dorë nga dëshira për përgjigje zyrtare me shkrim, kjo në

funksion të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të integritetit të personit konkret (në shumë raste sidomos për individë që tashmë nuk jetojnë) dhe në përmbushje të dëshirës të kërkuarit, në funksion dhe derivat të të cilëve jemi në raport me kërkimin e tyre.

Në këto procedura janë njohur Anëtarët, dokumentacioni është parë prej tyre dhe është trajtuar në mbledhjet e Autoritetit.

2. Dinamikat e procesit të informimit të institucioneve kushtetuese apo autoriteteve publike.

Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të ligjit, hartimi i këtij ligji u orientua nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Komisioni i Venecias si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për mundësimin e qasjes në dokumentet e mëparshme të shërbimit të inteligjencës komuniste. Gjithashtu ligji parashikon, deri në 31 mars të vitit 2020, verifikimin e zyrtarëve, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, duke kërkuar nga Autoriteti që t'i përgjigjet të gjitha kërkesave institucionale dhe individuale për informacion mbi sfondin e kandidatëve. Në këto raste, detyra e Autoritetit është e kufizuar në marrjen e informacionit pasi Autoriteti vihet në lëvizje vetëm mbi bazën e kërkesës. Ai nuk vendos sanksione apo gjykon mbi përshtatshmërinë dhe denjësinë e individit për detyrë.

Sipas ligjit nr. 45/2015 Autoriteti ka detyrimin t'i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve

kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra si:

- ✓ President i Republikës;
- ✓ anëtarë të Këshillit të Ministrave, zëvendësministra, funksionarë politikë, anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to;
- ✓ anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarë e prokurorë në gjykatat e prokuroritë e të gjitha niveleve;
- ✓ anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- ✓ funksionarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, Gardën e Republikës, oficerë me gradën "Gjeneral" dhe "Kolonel";
- ✓ prefektë;
- ✓ drejtues dhe punonjës të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe çdo njësie tjetër të inteligjencës;
- ✓ drejtues në Policinë e Shtetit deri në nivel qarku dhe komisariati;
- ✓ drejtues të përfaqësive diplomatike;
- ✓ guvernatorë dhe zëvendësguvernatorë të Bankës së Shqipërisë;
- ✓ anëtarë të Akademisë së Shkencave, rektorë, zëvendës rektorë, dekanë, zëvendës dekanë në universitetet publike;
- ✓ Drejtor i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorë të Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

- ✓ Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare;
- ✓ çdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti apo i zgjedhur nga Kuvendi.

Brenda kuadrit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 45/2015, Autoriteti, në vlerësim të realizimit në kohë të procedurave, fillimisht adresoi shkresërisht institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike Formularin-Tip të Aplikimit, njëherazi për ti ardhur në ndihmë atyre, ky formular është vendosur edhe në webfaqen e AIDSSH-së.

Autoriteti i përgjigjet institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike për zyrtarin që emërohet ose ngrihet në detyrë, përkatësisht nëse:

- ✓ ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;
- ✓ ka qenë ose jo bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ✓ figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Institucionet kombëtare dhe autoritetet publike, në kuadër të transparencës dhe në funksion të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të zyrtarëve, përpara emërimit ose ngritjes në detyrë, udhëhiqen nga parimi i mosndëshkimit kolektiv dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të individit.

Për vitin 2017, janë zhvilluar procedurat ligjore për 46 *kërkesa, të paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike*, për verifikimin e figurës së kandidatëve/zyrtarëve, për t'u emëruar ose ngritur në detyrë, kur kjo është kërkuar në

kuadër të vlerësimit, të cilësive etike, morale dhe profesionale të tyre, sipas legjislacionit përkatës.

Procedurat e ndjekura;

Mbi bazën e dokumentacionit të administruar, referuar gjeneraliteteve të plotësuara në Formularin–Tip, dhe objektit të kërkesës, janë verifikuar kërkesat përkatëse nga ana formale dhe ka përgatitur aktet (relacion, materiale mbështetëse) në funksion të trajtimit dhe shqyrtimit të kërkesë në mbledhjen e Autoritetit, për legjitimitetin e saj.

Kryesisht kërkesat e paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, pas legjitimitetit të tyre nga Autoriteti, janë trajtuar me përparësi, duke preluar kërkesat e cilësuar të rëndësishme dhe sensitive, në interes të opinionit publik. Këto kërkesa kryesisht kanë qenë me afat të kufizuar kohor në varësi të shqyrtimit të tyre në institucionin përkatës, megjithatë nga ana jonë në çdo rast me angazhimin, ndihmën dhe përkrahjen e anëtarëve është arritur të bëhet verifikimi, pa cenuar cilësinë dhe veçanërisht rezultatin e kërkimit.

Përcjellja e shkresave të adresuara nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, fillimisht institucioneve përkatëse që dispononin dokumentacionin e kërkuar, MPB, SHISH, DPA, Ministrisë Mbrojtjes dhe më pas Drejtorisë së Arkivit këtu, pas disponimit dhe kalimit të dokumentacionit përkatës në administrim të tij.

Mbi bazën e dokumentacionit të administruar, përgatitja e akteve (relacion, projekt vendime, materiale ndihmëse) që shërbejnë për mbledhjen e Autoritetit, në shqyrtimin e kërkesës dhe kthimin


e përgjigjes të kërkesave të adresuara nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike.

Përgatitja e draft-vendimit dhe dokumenti shkresor për kthimin e përgjigjes institucionit kushtetues apo autoritetit publike, mbi bazën e vendimmarrjes së Autoritetit dhe konfirmimit në dhënien e përgjigjes subjekteve të sipërcituara, referuar objektit të kërkesës.

Vlen të përmendet fakti se, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucionet kushtetuese, brenda afateve kohore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, filluam trajtimin me përparësi të kërkesës së Avokatit të Popullit, e cila ishte e lidhur me procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të kandidatëve për t'u zgjedhur si anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Vetting).

Në këtë kontekst, Autoriteti me transparencë, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm mori në shqyrtim çështjen, duke marrë në konsideratë jo vetëm raportin prevalues të ligjeve përkatëse të institucioneve kushtetuese, që në rastin konkret ishte Neni 179/b i Kushtetutës, Ligji nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku e mbështesnin kërkesën Avokati i Popullit, por edhe rolin që ligji i njeh Autoritetit në çështjen e “lustracionit”. Ky rol është mjaftueshmërisht i drejtpërdrejtë, vënie informacioni në dispozicion sipas kërkesës së paraqitur dhe në kuptim të ligjit 45/2015. Autoriteti ishte i qartë në qëndrimin e tij se, për vendosjen e pengesave ligjore për kandidatët e verifikuar, ju takon institucioneve kushtetuese, pasi të kenë marrë nga Autoriteti informacionin e kërkuar, për

304 Kërkesa



gjithçka që lidhet me objektin e ligjit.

Sa më sipër, në kohë reale (koha në dispozicion ishte e limituar, për arsye se, përgjigja e kërkesës kërkohet brenda 3 (tre) ditëve nga depozitimi i kërkesës në Autoritet), Autoriteti zhvilloi dhe përfundoi:

1. procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) kandidatëve që kishin aplikuar për t'u zgjedhur si anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi në këtë fushë dhe në kuptim të ligjit 45/2015.
2. procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të 25 (njëzet e pesë) kandidatëve që kishin aplikuar për t'u zgjedhur si anëtarë

në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi në këtë fushë (ligji 115/2016, për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë) dhe në kuptim të ligjit 45/2015.

3. procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të 3 (tre) kandidatëve që kishin aplikuar për t'u zgjedhur si anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e Avokatit të Popullit, në zbatim të legjislacionit në fuqi në këtë fushë (ligji 115/2016, për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë) dhe në kuptim të ligjit 45/2015.
4. procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të 3 (tre) kandidatëve që kishin aplikuar për t'u zgjedhur si anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e

Shoqërisë Civile, në zbatim të legjislationit në fuqi në këtë fushë (ligji 115/2016, për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë) dhe në kuptim të ligjit 45/2015.

5. procedurën e vlerësimit të cilësive etiko-morale të 7 (shtatë) kandidatëve që kishin aplikuar për t'u zgjedhur si anëtarë në Këshillin e Lartë të Gjyqësor, nga radhët e Shoqërisë Civile, në zbatim të legjislationit në fuqi në këtë fushë (ligji 115/2016, për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë) dhe në kuptim të ligjit 45/2015.

Vlen të përmendet se, në rastet e kërkesave institucionale të bëra nga institucione në ndryshim nga parashikimet e nenit 29-30 të ligjit 45/2015, me qëllim vetëpastrimi por pa shkelur të drejtat themelore të njeriut (në rastet kur këto institucione nuk kanë detyrim ligjor për verifikim të pastërtisë së figurës, por që me vullnetin e tyre kolektiv të shprehur nëpërmjet vendimmarrjes kolektive të përfshira në një proces transparent dhe demokratik për vetëpastrimin e tyre), kërkesa adresuar Autoritetit ishte kolektive ndërsa aplikimi (formularët) individualë. Autoriteti konstatoi se thirrjet sensibilizuese dhe promocioni, besueshmëria dhe funksionimi i tij kishte dhënë efektet e dëshiruara (rasti i partive që morën pjesë në zgjedhje dhe i fakultetit të ekonomisë). Nga verifikimi rezultuan raste me probleme, për individë që nuk mbartin detyrim për një verifikim të tillë, dhe në këtë kontekst Autoriteti, veprimi në përputhje të plotë me ligjin dhe me procedurë korrekte, nëpërmjet një vendimmarrje të arsyetuar dhe të kujdesshme duke bërë zgjidhjen e drejtë ligjore dhe logjike, me qëllim mbrojtjen e integritetit të individëve

3. Procesi i informimit të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Shqipërisë qershor 2017.

Ligji nr. 45/2015 ka parashikuar detyrimin e Autoritetit të informojë, deri në 5 vite pas hyrjes në fuqi të ligjit, pra deri në 31 mars të vitit 2020 edhe për këto subjekte për zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Shqipërisë kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet prej tyre për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale. Autoritetit vihet në lëvizje vetëm mbi bazën e kërkesës së subjekteve dhe nuk mund të veprojë kryesisht.

Për vitin 2017 janë zhvilluar procedurat ligjore për 2 (dy) *kërkesa, të paraqitura nga subjektet zgjedhore*, të regjistruara në KQZ, për zgjedhjet për deputet në Kuvend, datë 25 qershor 2017, respektivisht nga Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet (144 numri i kandidatëve për tu verifikuar) dhe Aleanca Popullore për Drejtësi (141 numri i kandidatëve për tu verifikuar), në lidhje me ekzistencën për kandidatët për deputet të të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për qëllime të transparencës së figurës së tyre, gjatë fushatës elektorale.

Njëherazi për vitin 2017, janë zhvilluar procedurat ligjore për 3 (tre) *kërkesa të paraqitura personalisht nga deputetë aktualë të Kuvendit të Shqipërisë*, për verifikimin e pastërtisë së figurës së tyre, sipas ligjit 45/2015.

Kërkesat e paraqitura nga dy subjektet zgjedhore të sipërcituara (PDIU dhe APD), si dhe kërkesat

e paraqitura nga vetë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, pas legjitimitetit të tyre në mbledhje të Autoritetit, janë trajtuar me përparësi, dhe në rastin e dy subjekteve zgjedhore e kushtëzuar kjo edhe nga koha në dispozicion e regjistrimit të listave shumë emërorë të këtyre subjekteve në KQZ.

Për sa i takon procedurave të ndjekura në rastet e sipërcituara ato janë të njëjta me procedurat e ndjekura për kërkesat e paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike.

4. Procesi i informimit për studiues / media etj.

Ligji ka parashikuar edhe informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për studiuesit dhe median. Në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, Autoriteti vë në dispozicion, mbi bazë kërkesë. Ndërkohë që parashikohen edhe rregulla për njohjen dhe shqyrtimin e këtyre dokumenteve nga këto subjekte kërkuuese.

Neni 37 i ligjit parashikon se, për qëllime të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, dokumentet, në të cilat janë fshirë emrat e palëve të treta dhe bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, mund të shqyrtohen në zyrën e Autoritetit.

Me kërkesë të personave të interesuar, kur shqyrtimi i dokumenteve sipas këtij ligji lejohet, mund të lëshohen publikatat, në cilat janë fshirë emrat e palëve të treta dhe bashkëpunëtorëve

të ish-Sigurimit të Shtetit. Publikatat nuk mund të përdoren nga marrësi për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar dhe as të përcillen tek marrës të tjerë.

Autoriteti në përmbushjen e detyrës dhe misionit të tij në kuadër të kujtesës dhe të edukimit qytetar në veprimtarinë e tij, siç parashikon ligji dhe nga eksperiencat pozitive të autoriteteve homologe veçanërisht ai Bullgar, duhet të krijojë dhe të ketë partner kryesor dhe si bashkudhëtarë të pandashme studiuesit dhe median, në funksion të përdorimit të formave dhe mjeteve të komunikimit për të informuar publikun lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni.

Procesi i hapjes së dosjeve merr një rëndësi e vlerë të veçantë kur kjo kërkohet dhe realizohet nga studiues/media, për qëllime kërkimore shkencore, informative në funksion të publikut dhe edukimit qytetar.

Për vitin 2017, janë zhvilluar procedurat ligjore për 25 (njëzet e pesë) të paraqitura nga studiues/media, të cilët i janë drejtuar me kërkesë Autoritetit, për njohjen me dokumente të veçanta, për qëllime kërkimore shkencore dhe në funksion të edukimit qytetar, nëpërmjet trajtimit të problematikës, fenomenologjisë dhe larg trajtesave individuale dhe personalizimeve, të cilat nuk ka asgjë të keqe apo pengesë por që mund dhe duhet të bëhet rast pas rasti, për figura dhe ngjarje të spikatura të kohës dhe arealit të veprimtarisë së tyre.

Vihet re interesi i treguar (megjithëse jo në nivelin e pritshmërisë) nga studiues/media, por njëherazi mund të themi se duke përjashtuar rreth 10 kërkesa për të cilat janë vazhduar procedurat deri

në kthimin e përgjigjes së kërkuarit në cilësinë e studiuarit apo medias, jemi ndeshur me kërkesa me objekt të gjerë dhe shtrirje kohore ose të papërcaktuar ose tepër të madhe, duke na vënë në disa raste në pamundësi reale për t'ju venë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Cilësia e subjekteve kërkuar të paraqitur si studiuar, nuk ka qënë në nivelin e pritshëm dhe të dëshiruar, në disa raste e pa identifikuar qartë për cilësinë e pretenduar, shkaqe për të cilat anëtarët kanë miratuar dhe vendosur disa kërkesa dhe kriteret shtesë.

5. Korrespondenca me Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me ecurinë e procesit të dëmshpërblimeve.

Ligji ka parashikuar trajtimin me përparësi të kërkesës për informim kur informacioni i kërkuar nevojitet për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi. Sipas nenit 2 ligji zbatohet për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar.

Referuar nenin 27 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e Ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist", të ndryshuar, Ministria e

Drejtësisë gjatë trajtimit të kërkesave të ish të dënuarve i drejtohet për kërkim informacioni Institucioneve, të cilat në zbatim të ligjit nr. 45/2015 dhe të VKM-së nr. 98/2017 detyrohen të dorëzojnë dhe bëjnë kalimin e dokumentacionit arkivor në administrim të Autoritetit.

Në nenin 26 të ligjit nr. 45/2015 parashikohet informimi i institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera, të cilat i drejtohen Autoritetit me kërkesë për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tyre.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara gjatë vitit 2017 në Sektorin e kërkesave për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi kanë ardhur **95** (nëntëdhjete e pesë) kërkesa nga Ministria e Drejtësisë për efekt dëmshpërblimi dhe për to janë bërë procedurat e brendshme për kontrollin dhe gjetjen e materialeve të kërkuara.

Gjithsej janë kthyer përgjigje **65** (gjashtëdhjetë e pesë) kërkesa nga e Ministria e Drejtësisë, vlen për tu theksuar se shkresat e para të ardhura kanë filluar në muajin gusht.

6. Te dhëna statistikore mbi numrin e kërkesave, legjitimitin e tyre në Autoritet, dhënie informacioni Institucioneve, apo autoriteteve publike, si dhe përgjigje subjekteve individual kërkuar, nëpërmjet vënies në dispozicion të dokumenteve arkivore dublikatë, apo në formë CD:

1. Në mbledhje të Autoritetit janë trajtuar paraprakisht dhe legjitimuar **rreth 280 (dyqind e tetëdhjetë) kërkesa individuale,**

- përt të cilat në raportin 65% është përmbyllur procedura mbi bazën e vendimmarrjes së Autoritetit dhe të tjerat janë në proces, ku kryesisht kemi të bëjmë me kërkesa, për të cilat ekzistojnë dokumente (dosje, fashikuj/ fletë regjistri etj) të krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Janë legjitimuar **25** (njëzet e pesë) kërkesat të paraqitura nga studiues/media, për njohjen me dokumente të veçanta, për qëllime kërkimore shkencore dhe në funksion të edukimit qytetar. Ka përfunduar procesi për **10** kërkesa, nëpërmjet vënies në dispozicion të dokumenteve arkivore, në zbatim të neneve 35, 36 dhe 37 të ligjit nr. 45/2015. Kërkesat e tjera janë për tu trajtuar në vitin pasardhës.
 3. Është kryer **dixhitalizimi i rreth 140 (njëqind e dyzet) dokumenteve** të administruar sipas rastit (dosje formulare, dosje e punës, dosje personale, dosje e hetuesisë, dosje hetimore gjyqësore, fashikuj, fletë regjistri etj), në total rreth 30.000 (tredhjet mijë) fletë, që i është vënë në dispozicion kërkuesit.
 4. Është kryer procesi i **anonimizimit të rreth 50 dosjeve formulare, personale dhe të punës**, të cilat ishin kryesisht në nivelin e klasifikimit “tepër sekret” dhe “sekret”, përpara procesit të njohjes dhe vënies në dispozicion personave të interesuar, në total 9000 fletë.
 5. Janë trajtuar me përparësi, paraprakisht dhe legjitimuar **48 (dyzet e tetë), kërkesa, të paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike**, për verifikimin e figurës së kandidatëve/zyrtarëve, për t’u emëruar ose ngritur në detyrë, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, të cilësive etike, morale dhe profesionale të tyre, sipas legjislacionit përkatës.
 6. Për **47 (dyzet e shtatë)** kërkesa është përmbyllur procedura mbi bazën e vendimmarrjes së Autoritetit në kohë reale.
 7. Kanë kaluar në **filtrin e verifikimit të pastërtisë së figurës rreth 821 (tetëqind e njëzet e një) kandidatë apo zyrtarë**, përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, apo kandidatë për deputet në zgjedhjet që sapo lamë pas, në kuadër të transparencës së fushatës zgjedhore.
 8. Mbi bazën e dokumentacionit të administruar, **rezultojnë pozitiv 795 figura të verifikuara** (nuk ekzistojnë dokumente të ish-sigurimit të shtetit për ta) dhe **negativ 13 figura të verifikuara** (figurojnë të ketë materiale në emër të tyre), nga Autoriteti, sipas nenit 29, pika 2, dhe nenit 30 të ligjit 45/2015.
 9. Për **197** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) emra kandidatësh që kanë aplikuar për t’u zgjedhur si anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Vetingu), është kryer procedura e vlerësimit të cilësive të tyre etiko- morale në kohë reale.
 10. Është kryer procedura e vlerësimit të cilësive etiko-morale të **51** (pesëdhjetë e një), kandidatëve për t’u zgjedhur si anëtarë

në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e Avokatisë, nga radhët e shoqërisë civile, nga radhët e pedagogëve të fakulteteve juridike dhe shkollës së Magjistraturës, **(ku 4 prej kandidatëve figuronin si gjyqtarë, prokurorë në procese penale politike dhe si bashkëpunëtorë.**

11. Numri i kandidatëve të verifikuar, për t'u zgjedhur deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, datë 25 qershor 2017, të propozuar nga PDIU, është 144 (njëqind e dyzet e katër) dhe të propozuar nga APD, është 141 (njëqind e dyzet e një) si dhe tre deputet të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht faktit të mospasjes si detyrim ligjor të parashikuar në ligjin nr. 45/2015, kanë paraqitur kërkesë për verifikimin e figurës së pastërtisë, procedurë kjo që është përmbyllur nga Autoritetit.
12. Kanë paraqitur ankesë dhe kanë venë në lëvizje Autoritetin për të sqaruar faktin si figurojnë në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 3 (tre) shtetas, për të cilat Autoriteti është në proces shqyrtimi.
13. Institucionet kushtetuese apo Autoritetet publike që kanë paraqitur kërkesa (një ose më shumë në kohë të ndryshme) të cilat janë trajtuar pranë AIDSSH-së:
14. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Avokati i Popullit, Subjekte Politike (PDIU dhe APD) për zgjedhjet për Kuvend, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Brendshme (Drejtoria

e Përgjithshme e Policisë), Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Rektorati i UT, Fakulteti Ekonomik i UT, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i UT, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

15. Janë verifikuar figura qendrore me peshë dhe rëndësi në jetën politike të vendit si Presidenti i Republikës, Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Vettingu), Anëtarë të KLGJ-së, Anëtarë të KLP-së, Gjeneralë, Avokati i Popullit, anëtarë të KQZ-së, Anëtarë të Akademisë së Shkencave, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, etj, çka përbëjnë, përparim në koeficientin e njohjes dhe zbatimin e ligjit, vlerësim për institucionin dhe besueshmëri për publikun.

4. 4. Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar

Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, është përgjegjëse për mbështetjen veprimtarisë hulumtuese, të kërkimit shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve. Në përbërje të kësaj Drejtorie janë Sektori i projekteve studimore dhe audio vizuale dhe Sektori i kërkesave për qëllime studimore.



Detyrat e përcaktuara në Rregullore për këtë Drejtori janë përmbushur nga Drejtoritë/Sektorët/Sekretare e Kryetares për shkak se në këtë Drejtori nuk është punësuar asnjë person me rekrutimet e viti 2017. Ndërkohë që kërkesat për informimin nga studiues, media janë trajtuar gjerësisht në përmbajtjen e aktivitetit të punës të Drejtorisë së Informacionit.

Autoritetit ka zhvilluar disa aktivitete në funksion të edukimit qytetar, për promovimin e ngjarjeve historike, vizitave njohëse, përkujtimore si dhe në kuadrin e kalendarit të ngjarjeve përkujtimore të kujtesës, të miratuar në mbledhjet e tij.

1 - Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Musine Kolararit, në bashkëpunim me OSCE u zhvillua vizitë në qytetin e Rrëshenit ku u kryen takime

me përfaqësues të pushtit vendor si dhe u vizitua rruga që mbante emrin “Musine Kolarari” dhe Biblioteka e qytetit. Mbi bazën e kërkesës së mbesës së të ndjerës Musine Kolarari Autoriteti zhvilloi procedurat për informimin e familjarëve për dokumentacionit që ndodhej në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit. Hapja dhe dorëzimi i dosjes, familjarëve të së ndjerës u bë në datën 10 shkurt, datë në të cilën përkon me ditëlindjen e saj.

2 - Me Urdhrin Nr. 16, datë 23.02.2017 është ngritur grupi i punës për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat me qëllim zbatimin e ligjit 45/2015. Ky grup pune i përbërë nga anëtarët e Autoritetit ka marrë kontakte me drejtues në Institucionet si Bashki, Gjykatë, Arkivat vendore etj., në qytetet

Sarandë, Vlorë, Gjirokastrë, Tepelenë, Berat, Shkodër, me qëllim identifikimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, gjendjen e tyre dhe fillimin e procedurave për kalimin në administrim të Autoritetit në zbatim të ligjit nr. 45/2015 dhe të VKM-së nr. 98/2017.

3 - Në bashkëpunim me përfaqësues të OSBE dhe Trupit Diplomatik në Shqipëri, Institutin e Integritit të Përndjekurve Politikë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, institucione të tjera shtetërore, dhe Bashkinë Tepelenë, në datën 30 gusht 2017 në Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, organizoi prezantimin e projektit “Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës” në përkujtim të viktimave të cilët vuajtën dënimin në kampet e punës së detyruar në vendin tonë gjatë regjimit diktatorial komunist. Projekti përfshin: i) Rindërtimin e njëres prej barakave siç ka qenë në kohën kur funksiononte si kamp dëbimi (kthimin e saj në identitet); ii) Mbjelljen e 300 fidanëve për përkujtimin e 300 fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në Kampin e Tepelenës dhe janë pa varr; iii) Vendosjen e stendave me dëshmi (fotografi dhe dëshmi arkivore) për kampet e dëbim – internimit. Për këtë qëllim, u bë kërkim i thelluar në Arkivin e sistemit të Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Dokumentacioni i gjetur në këto arkiva ka shërbyer për nxjerrjen e të dhënave statistikore për numrin e të internuarve në këtë Kamp, numrin e lindjeve dhe vdekjeve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe. Në këtë aktivitet nuk ka munguar

bashkëpunimi me Bashkinë Tepelenë, Institutin e të Përndjekurve Politik dhe Institutin e Studimeve të Krimeve kundër Komunizmit si dhe shoqata dhe organizata vendase dhe të huaja si dhe grupet e interesit. Njëkohësisht kujtojmë se projekti është i përfshirë në Programin e Qeverisë 2017-2021.

4 - Përfaqësues të Autoritetit, të Fakultetit, Ambasada Italiane, familjarë të Sabiha Kasimatit dhe studiues të saj u mbledhën në Fakultetin e Shkencave të Natyrës më 15 shtator 2017, ora 10.00 të përkujtonin figurën dhe veprën e znj. Sabiha Kasimatit si dhe përndjekjen gjatë diktaturës, që i kushtoi asaj jetën dhe mohimin e veprës për tërë këto vite. Aktiviteti është realizuar për ditëlindjen e saj, që përkon me këtë ditë, si një përpjekje për të promovuar të vërtetën, rehabilitimin e figurave të përndjekura nga komunizmi si dhe të edukimit qytetar si mision të ri të institucionit të kujtesës (AIDSSH). Prof. Dr. Spiro Drushku, Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, foli për staturën e saj shkencore, kontributet dhe impaktin e veprës së saj, e cila ishte ndër gratë e shquara shqiptare që duhet të tërheqë vëmendjen e studiuesve dhe të institucioneve për t’ia hulumtuar jetën, veprimtarinë dhe veprën si dhe për ta vlerësuar siç e meriton. Edhe Ambasador i Republikës Italiane në Tiranë (TBC) Sh.T.Z. Alberto Cutillo foli në lidhje me përballjen e kujtimit në kohën tonë dhe reagimin e shoqërisë së sotme. Nga ana e tij, ai ka shprehur dhe mbështetje për aktivitete të ngjashme. Puna shkencore e Sabiha Kasimatit është pasqyruar në studimin “Fauna ittica d’acqua dolce dell’Albania: tesi di laurea” (“Fauna ihtike e ujrave të ëmbla të Shqipërisë”), tezë doktorature



që ajo e mbrojti në Universitetin e Torinos, në vitin 1941. Këtu për herë të parë u dhanë karakteret e iktiologjisë shqiptare. Veçmas listës të specieve dhe varieteteve që formojnë faunën e peshkut në ambiente të ndryshme ihtiologjike, përshkrim gjeografik dhe biologjik të mjediseve të ndryshme ihtiologjike, ekzaminim të materialit të mbledhur, ajo analizon 7 familje peshqish ka bërë edhe një përshkrim të shkurtër të industrisë së peshkimit në Shqipëri. Si shefe e sektorit të zoologjisë ajo u mor vetëm me ihtiologji, fushë që e kishte hulumtuar që nga koha e studimeve universitare. Ndërkohë, familjarët kanë dhënë shumë episode të tjera, që lidheshin me jetën e saj dhe aspekte të panjohura të Sabiha Kasimatit dhe përfaqësues të Autoritetit bënë prezent të dhëna mbi gjendjen e dokumentacionit arkivor që gjendet në dosjen e saj.

5 - Në bashkëpunim me OSBE dhe UNDP janë përgatitur dhe janë shpërndarë fletëpalosje dhe disqe në përmbajtje të të cilave është synuar njohja me ligjin nr. 45/2015, veprimtarinë e Autoritetit dhe planin strategjik të Autoritetit.

6 - Në datën 10 Tetor 2017 në Sallën Plenare të Parlamentit, në kuadër të 70-vjetorit të ekzekutimit të grupit të deputeteve në Parlamentin Shqiptar, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Krimeve të Komunizmit dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike u organizua një veprimtari përkujtimore me rastin e përkujtimit të 70 vjetorit të ekzekutimit të “grupit të deputetëve”, me temë “Deputetët për Deputetët” në të cilin Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të tri grupeve parlamentare, si dhe përfaqësues të



Trupit Diplomatik në vendin tonë, reflektuan në diskutimet e tyre, në këtë veprimtari, mbi ngjarjen e 10 tetorit 1947, si dhe mbi mendimin ndryshe dhe vlerat evropiane të deputetëve, vepra dhe jeta e së cilëve u ndërpre në mes. Në aktivitet morën pjesë shumë të ftuar personalitete të vendit tonë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare Kryeministri i Shqipërisë, deputetë, përfaqësues ndërkombëtarë, gazetarë e familjarë. Aktiviteti u zhvillua në përputhje me misionin të Autoritetit si për trajtimin e së shkuarës komuniste, por dhe edukimit qytetar, se vetëm duke u përballur pa frikë dhe me ndershmëri me të kaluarën, ne do të mundemi më në fund të ndërtojmë një shoqëri të drejtë, një shoqëri të hapur dhe një shoqëri që mund të prodhojë mendim dhe zhvillim.

7 - Në datë 22 Nëntor 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe Institutin e Historisë, organizuan një aktivitet përkujtimor për ekzekutimin e “Grupit Sabotator” të Inxhinierëve të Maliqit në përkujtim të ditës së ekzekutimit të tyre dhe për të hedhur dritë mbi pushkatimin e inxhinierëve. Në aktivitet morën pjesë përfaqësuesi i Avokatit i Popullit, Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, përfaqësuesja e Akademisë së Studimeve Albanologjike, familjarë të viktimave, student gazetarë dhe media. Për fat të keq, ky ishte vetëm një episod nga shumë e shumë të tjerë që i kushtuan Shqipërisë elitën intelektuale të vendit.



8 - Në kuadër të njohjes së stafit të Autoritetit me vendet e kujtesës dhe prezantimin e misionit të Autoritetit, në datën 20 dhjetor 2017, në Bibliotekën e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër u organizua një takim me student të qytetit të Shkodrës në të cilin merrnin pjesë dhe shoqata e ish-të përndjekurve politikë si dhe media të ndryshme. Pas kësaj u vizitua muzeu Muzeu i kujtesës historike, Kisha Françeskane dhe Varreza e Rrmajt, të njohura edhe për diçka tjetër: për plumbat breshëri të lëshuar mbi dhjetëra klerikë katolik intelektualë, të pa fajshëm të ekzekutuar gjatë diktaturës komuniste në vitin 1945-1948.

Siç përmendëm më sipër, në funksion të të gjithë aktiviteteve të zhvilluara, fushata e gjerë sensibilizuese është karakterizuar edhe nga shpërndarja e materialeve ndërgjegjëse. Për hartimin dhe botimin e këtyre broshurave e fletëpalosjeve dhe CD, stafi ynë ka treguar impenjim maksimal. Gjithashtu, duhet përmendur se, në botimin e disa prej të këtyre materialeve ndërgjegjëse ka dhënë ndihmesën e saj të konsiderueshme edhe OSBE.

4.5 Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe e Financës.

Drejtoria kryen administrimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare të institucionit, ndjek në mënyrë sistematike realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të institucionit, përgatit Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) të institucionit, parashikon realizimin e fondeve të prokuruar dhe vlerësimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit të organizuara nga institucioni duke përfshirë llogaritjen e fondeve limit dhe vlerësimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit publik, siguron ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktiveve në pronësi të institucionit, si dhe menaxhon burimet njerëzore, çështjet juridike, infrastrukturën, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse. Drejtoria ka në strukturë Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokollit, Sektorin Juridik dhe Prokurimeve, Sektorin e Financave dhe Sektorin e Logjistikës dhe mirëmbajtjes dhe ka funksionuar për vitin 2017 vetëm me dy përgjegjëse Sektori, tre specialistë dhe pas muajit prill janë punësuar 2 punonjës me kontratë.

1. Infrastruktura

Në kuadër të mbështetjes së dhënë nga qeveria shqiptare, dëshiroj të vë në dukje angazhimin maksimal dhe të vazhdueshëm të saj, i cili u konkretizua me Vendimin nr. 935, datë 28.12.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit, të

objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, brenda territorit të pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes”, me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, të ndryshuar” është përcaktuar ambienti ku do të ushtrojë veprimtarinë e vet Autoriteti.

Pas përfundimit të procedurave të marrjes në dorëzim të godinës nga Komanda e Doktrinës dhe e Stërviçjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes duke qenë se godina është në kushte të papërshtatshme për t’u shfrytëzuar në gjendjen aktuale, ka filluar menjëherë puna për “Hartimin e Projekt - Zbatimit dhe Preventivit Teknik për Rikonstruksionin e Objektit Nr. 52, me emërtim ‘Arkivi i Ri’, me sipërfaqe 2893,2m2 brenda territorit të pronës Nr. 12, me emërtim ‘Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes’, me vendndodhje Lagja Nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë.”

Për bërjen funksionale të godinës janë marrë masat e mëposhtme:

- ✓ Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen në dorëzim të Godinës së Re.
- ✓ Ngritja e Grupit të Punës për hartimin dhe përfundimin e Detyrës të Projektimit për “Rikonstruksionin, përshtatjen e Godinës së Re të Autoritetit”.
- ✓ Bashkëpunimi me Institutin e Ndërtimit për hartimin dhe përfundimin e projektit dhe preventivave për “Rikonstruksionin, përshtatjen e Godinës së Re të Autoritetit”.

- ✓ Bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë të Ndërtimit dhe me Institutin e Ndërtimit për kryerjen e Oponencës Teknike të projektit dhe preventivave për “Rikonstruksionin, përshtatjen e Godinës së Re të Autoritetit”.
- ✓ Bashkëpunimi me Ministrinë e Integritimit për hartimin e Koncept-Notes për financimin në kuadër të fondeve IPA të BE, të planit strategjik 2017-2020 të Autoritetit, ku pjesa me e rëndësishme e financimit do të jetë rikonstruksioni i godinës.
- ✓ Diskutimi i projekt-idesë dhe projekt preventivave.
- ✓ Shqyrtimi, diskutimi, vërejtjet e projektit dhe preventivave përfundimtarë.
- ✓ Marrja në dorëzim zyrtarisht, me proces-verbal, i projektit dhe preventivave përfundimtare.
- ✓ Shqyrtimi, diskutimi, vërejtjet e oponencës teknike të projektit dhe preventivave përfundimtarë.
- ✓ Marrja në dorëzim e oponencës teknike të projektit dhe preventivave.
- ✓ Hapja e procedurës së tenderimit të punimeve të pjeshme të rikonstruksionit të godinës, procedurë e cila nuk u realizuar për shkak të mosparaqitjes së operatorëve ekonomik.

Ka përfunduar e gjithë procedura ligjore për regjistrimin e godinës së Institucionit, në zbatim të VKM-së nr. 935/2016. Me Certifikatën e pronësisë nr. 1705074, datë 13.09.2017, lëshuar nga ZVRPP Tiranë është regjistruar Objekti në emër të AIDSSH-së, i cili ndodhet në Zonën kadastrale nr. 8130, me numër pasurie nr. 2/12/ND, Volumi 28, faqe 1888 me sipërfaqe totale të pasurisë dhe të ndërtesës prej 1,025.00 m².

Në referencë të detyrës së Projektimit si dhe kryerja e Oponencës Teknike për Projektin e Teknik. Vlera e plotë e Projektit **për rikonstruksionin e godinës 133.000.000 lekë pa tvsh.**

Duke patur parasysh gjendjen ekzistuese të godinës, ndërhyrjet komplekse të kërkuara, ndërlidhjen e detyrueshme të sistemeve të infrastrukturës të godinës nga njeri ambient në tjetrin, nga njeri kat në tjetrin dhe pikërisht për të reflektuar idenë që me fondet e vena në dispozicion nga qeveria për vitin 2017 në shumën prej **8.059.000** lekë të bëhej e mundur përshtatja e arkivit/katit të nëndheshëm që në hartimin e detyrës të projektimit nga ana e AIDSSH ju kërkua projektuesit që projekti teknik përfundimtar dhe preventivat përfundimtare të hartoheshin të tilla që të lejonin zbatimin e projektit në 2 faza, konkretisht:

- ✓ Faza 1: Rikonstruksioni i pjesshëm por i detyrueshëm i disa sistemeve të nevojshme të infrastrukturës (sistemi hidraulik, sistemi elektrik, sistemi i sigurisë fizike&elektronike etj.) dhe rikonstruksioni i plote nga ana ndërtimore dhe i sistemeve të tjera të detyrueshme për arkivin/katin e nëndheshëm (ventilim-kondicionimi, sistemi i mbrojtjes nga zjarri)
- ✓ Faza 2: Rikonstruksioni i plotë nga ana ndërtimore dhe i të gjithë sistemeve të infrastrukturës për pjesën tjetër të godinës.

Meqenëse preventivi i Fazës 1 ishte më i lartë se fondi i venë në dispozicion, për të mos djegur këtë fond nga ana e AIDSSH, iu kërkua Projektuesit që të hartonte një preventiv minimalisht në shumën e

Tabela 1

Llog.	Përshkrimi	Plani i buxhetit - Viti 2017
Ekonomike		(në mijë lekë)
600	Fond Page	21850.00
601	Kontribute Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore	3150.00
602	Mallra dhe shërbime të tjera	10000.00
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	50.00
231	Shpenzime kapitale	10,000.00
Totali		45.050.00

Tabela 2

Llog.	Përshkrimi	Plani i buxhetit	Realizimi i buxhetit 2017
Ekonomike		Viti 2017	(në mijë lekë)
600	Fond Page	21850.00	21492.00
601	Kontribute Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore	3150.00	3103.00
602	Mallra dhe shërbime të tjera	10000.00	6963.00
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	50.00	50.00
230-231	Shpenzime kapitale	10,000.00	5880.00
Totali		45050.00	37488.00
Në % kundrejt totalit			83%

mbetur që të bënte të mundur kryerjen e punimeve minimale, të detyrueshme dhe të domosdoshme ndërtimore për të vënë në gjendje pune (pa sistemet e ventilim-kondicionimit, pa sistemet e mbrojtjes nga zjarri, pa sistemet e sigurisë) një rën nga 4 hapësirat e parashikuara si sipërfaqe arkivimi në katin e nëndheshëm.

Preventivi i hartuar u prokurua në muajin Nëntor, pasi u miratuar fondi tjetër për rialokim nga Ministria e Financës dhe pavarësisht interesit dhe paraqitjes të disa subjekteve për të tërhequr dokumentet përkatës gjatë procedurës së tenderimit, nuk pati as edhe një oferte nga ana e tyre.

Aktualisht, jemi në statusin që është hartuar

një projekt teknik dhe preventiva përkatës të përfunduar, i parashikuar me 2 faza zbatimi. Ndërkohë që janë vetëm 2 milion lekë fond investimesh të vëna në dispozicion për buxhetin e vitit 2018.

2. Administrimi i fondeve buxhetore

Me ligjin nr. 136/2016 “Për Buxhetin” janë miratuar fondet buxhetore për vitin 2017 për AIDSSH-së, në vlerën **45 050 mijë lekë**, të planifikuara dhe detajuara sipas strukturës (Shih Tabela 1),

Janë realizuar sipas tabelës (Shih Tabela 2).

Analiza sipas zërave kontabël:

Fondi i Pagave dhe i Sigurimeve Shoqërore & Shëndetësore, (600-601), për vitin 2017 është realizuar në vlerën **21 492** mijë lekë, ose **98.36** % e fondeve të alokuara. Bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, numri i punonjësve sipas strukturës së AIDSSH-së është 20. Numri faktik i punonjësve të AIDSSH-së është po ashtu 20.

Fondi për Shpenzime Korente të tjera (602-606), për vitin 2017, është realizuar në vlerën **7 013** mijë lekë ose **70.13** % e fondeve të alokuara. Ky fond është realizuar për:

- ✓ Shpenzime për blerje furnizime të ndryshme si kancelari, materiale për pastrim, bojë dhe tonera për funksionim pajisje printerë dhe fotokopje, etj.
- ✓ Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të AIDSSH-së, sigurimit të standardeve të njëjta në zbatimin e ligjit nr. 45/2015.
- ✓ Shpenzime për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kryetares, anëtarëve dhe sekretariatit teknik të AIDSSH-së në aktivitete dhe takime pune të ndryshme jashtë Shqipërisë.

Përsa i përket Fondit për Shpenzime Kapitale, (230-231):

- ✓ Nënartikulli “Blerje pajisje zyre”, fondi prej 1 450 mijë lekë është prokuruar në vlerën 974 mijë lekë.
- ✓ Nënartikulli “Blerje pajisje elektronike”, fondi prej 3 750 mijë lekë është prokuruar në vlerën 491 mijë lekë.

- ✓ Shuma prej 4 800 mijë lekë, e buxhetuar për nënartikullin “Rikonstruksion godine”, u rialokuan fonde ne vlerën 3 259 mijë lekë, por procedura e prokurimit nuk u realizua. Ne këtë zë nuk kemi realizim për vitin 2017.
- ✓ Nënartikulli “Oponencë” dhe “Hartim projekti” u alokuan fonde nga zëri “Rikonstruksion godine” përkatësisht në vlerat 140 mijë lekë dhe 4 274 mije lekë dhe u realizuan në masën 100% dhe u paguan brenda vitit 2017.

3. Realizimi i procedurave të prokurimit.

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2017, në zbatim të rregullave të prokurimit publik, bazuar në legjislacionin në fuqi Sektori Juridik dhe i Prokurimeve përgatiti regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2017.

Ky regjistër u dërgua për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe një kopje iu dërgua Ministrisë së Financave si dhe Degës së Thesarit, sipas legjislacionit në fuqi. Pas botimit të regjistrin të parashikimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik, Sektori i Prokurimeve filloi punën për plotësimin e dokumentacionit për shpalljen e procedurave.

Procedurat standarde të prokurimit kryesisht u zhvilluan me mjete elektronike nëpërmjet sistemit on-line të Agjencisë së Prokurimit Publik. Janë zhvilluar gjithsej 44 procedura prokurimi, nga të cilat:

- ✓ 1 procedure “kërkese për propozim” për shkak te vlerës nën kufirin e ulët monetar,

- ✓ 42 procedura me Vlerë të Vogël për shkak të vlerës së përllogaritur të kontratës,
- ✓ 1 procedurë me Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës (proceure prokurimi e klasifikuar).

Si rezultat i konkurrencës, u arrit që në përfundim të 43 procedurave të prokurimit të realizuara kishte një efekt ekonomik pozitiv ndaj fondit limit. Procedurat e prokurimit të planifikuara për vitin 2017 në zërin “shpenzime mallra dhe shërbime” (602) përfunduan brenda afatit të përcaktuar në rregullat e prokurimit, pra para datës 31 dhjetor.

Ndërsa, procedura e prokurimit për rikonstruksionin e godinës nuk u realizua, për shkak të mosparaqitjes të asnjë operatori ekonomik në këtë tender. Me Urdhrin nr. 65, datë 03.11.2017, “Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit për Kërkim të Ofertave”, për procedurën e prokurimit “Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” me objekt: *“Rikonstruksioni dhe përshtatje e Arkivës së Godinës së re të Autoritetit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 22.10.2014, “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e Informacionit të Klasifikuar në fushën Industriale”, njësia e prokurimit ftoi për pjesëmarrje Operatorët Ekonomik të pajisur me certifikatë sigurie, sipas shkresës nr. 12726 datë 08.11.2017 të DSIK.*

Komisioni i Negocimit dhe Vlerësimit të ofertave dhe Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, konstatuan se është e pamundur të realizohet procedura

e prokurimit, për shkak **se në datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për ofertë nuk u paraqit asnjë operator ekonomik.** Në këto kushte, Komisioni vendos të anulojë procedurën e prokurimit. Afati kohor i mbetur deri në fund të vitit kalendarik 2017, nuk ishte i mjaftueshëm për zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve dhe përdorimin e fondit në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2017, ndaj për këtë arsye Autoriteti kontraktor AIDSSH nuk rifilloi më pas me këtë procedurë prokurimi.

4. Personeli i AIDSSH-së, rekrutimet dhe trajnimet

Vendimi i Kuvendit Nr. 95, datë 22.12.2016 për strukturën dhe organikën përcakton që AIDSSH duhet të ketë një personel prej 60 punonjësish, ku 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi (Nr. 79, Nr. 80, Nr. 81, Nr. 82, Nr. 83 datë 17.11.2017).

Ligji i buxhetit për vitin 2017 vuri në dispozicion të AIDSSH një fond page për një numër prej 20 punonjësish, ku në këtë numër përfshiheshin edhe 5 Anëtarët e Autoritetit të zgjedhur, emëruar nga Kuvendi.

Neni 12, pika 5 e ligjit nr. 45/2015 shprehet *“Marrëdhëniet e punës së punonjësve të sekretariatit teknik i nënshtrohen legjislacionit të punës”.* Meqenëse shprehja *“legjislacioni i punës”* lë vend për interpretim, përpara fillimit të procedurave të rekrutimit, punësimit të punonjësve

të Sekretariatit Teknik, Autoriteti kërkoi sqarime të mëtejshme pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, me anë të shkresës nr. 15 prot., datë 09.01.2017 dhe interpretim të pikës 5, të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 nga Komisioneri i Shërbimit Civil, me shkresën nr. 15/1 prot., datë 09.01.2017 në lidhje me llojin e procedurave të rekrutimit, punësimit nëse ato do të ndiqnin, do të bëheshin në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës, apo do të bëheshin në përputhje dhe do ti nënshtroheshin detyrimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji. Përgjigjet zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr. 52/1 prot., datë 13.01.2017 dhe të Komisionerit të Shërbimit Civil me shkresën nr. 10/1 prot., datë 13.01.2017 përcaktonin që procedurat e rekrutimit, punësimit të punonjësve të Sekretariatit Teknik do të bëhen në përputhje dhe do ti nënshtroheshin detyrimeve, kërkesave të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Si institucion i pavarur, në zbatim të Vendimit të Kuvendit Nr. 95, datë 22.12.2016, bazuar në ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, VKM-ve përkatëse që rregullojnë procesin dhe procedurat e rekrutimit si dhe Kodin e Punës, AIDSSH filloi dhe përfundoi procesin e rekrutimit të personelit, që i lejonte buxheti i vitit 2017, gjatë periudhës Janar-Mars 2017.

AIDSSH-ja gjatë procesit të rekrutimit është udhëhequr nga parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësisë profesionale e mos diskriminimit. Rekrutimi është kryer nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Ky proces përzgjedhës është bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi të hapur, që përfshin një testim të shkruar dhe me gojë. Çdo fazë e ndjekur gjatë procedurave të rekrutimit është dërguar për shpallje dhe njoftim, sipas legjislationit në fuqi në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP). Të gjitha procedurat e rekrutimit janë realizuar nëpërmjet njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit në bashkëpunim edhe me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Kjo për faktin se, Institucioni i krijuar për herë të parë me ligjin nr. 45/2015 nuk i kishte ende kapacitetet njerëzore dhe strukturën përkatëse të plotësuar për të realizuar e vetme procedurat e para të rekrutimit.

Në zbatim të VKM Nr. 251, datë 29.3.2017, “Për Punonjësit me Kontratë të Përkohshme për Vitin 2017 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, AIDSSH rekrutoi edhe 2 punonjës shtesë me kontratë të përkohshme.

Në përfundim të procesit dhe procedurave të rekrutimit për vitin 2017, personeli i AIDSSH përbëhet nga 22 punonjës dhe konkretisht :

5 Anëtarë të Autoritetit (Vendime të Kuvendit)

1 Sekretar i Përgjithshëm

(Nëpunës i Nivelit të Lartë Drejtues, Ligji për Nëpunësin Civil)

1 Drejtor Drejtorie

(Nëpunës i Nivelit të Mesëm Drejtues, Ligji për Nëpunësin Civil)

5 Përgjegjës Sektori

(Nëpunës i Nivelit të Ulët Drejtues, Ligji për Nëpunësin Civil)

6 Specialistë

(Nëpunës të Nivelit Ekzekutiv, Ligji për Nëpunësin Civil)

1 Asistente e Autoritetit

(Kodi i Punës)

1 Shofer i Autoritetit

(Kodi i Punës)

1 Teknik Mirëmbajtje

(VKM Nr. 251, Kodi i Punës)

1 Sanitare

(VKM Nr. 251, Kodi i Punës)

Janë plotësuar dhe përditësuar dosjet personale të çdo punonjësi, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të Kodit të Punës, si dhe të kërkesave specifike që kërkohen në nenin 12 të ligjit nr. 45/2015. Është pajisur personeli i Stafit të Sekretariatit Teknik me certifikatat e sigurisë të nivelit përkatës në përputhje me kërkesat e pozicioneve të punës.

Po kështu janë plotësuar deklaratat përkatëse që për periudhën nga data 29 nëntor 1944 deri në datë 2 korrik 1991, punonjësi, personel i AIDSSH-së nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme.

Disa të dhëna të personelit të rekrutuar që i përkasin Sekretariatit Teknik prej 16 punonjësish, ku nuk përfshihen 5 Anëtarët e Autoritetit dhe asistentja e Autoritetit:

- ✓ 93.7 % e tyre kanë minimumi 3 vjet pune në administratën shtetërore,
- ✓ 87.5 % e tyre kanë përfunduar arsimin e lartë,
- ✓ 43.75 % e tyre janë me formim Juridik
- ✓ 18.75% e tyre janë me formim Gjuhë-Letërsi, Histori, Gjuhë të Huaj
- ✓ 12.75% e tyre janë me formim Ekonomik
- ✓ 12.75% e tyre janë me formim Inxhinierik, Informatik

Është ndërmarrë dhe ka përfunduar rishikimi, plotësimi dhe përshtatja e përshkrimeve të punës për të gjithë pozicionet e rekrutuara në përputhje me kërkesat konkrete të pozicionit në AIDSSH, formën dhe modelin e kërkuar nga DAP.

Gjatë vitit 2017 është kryer dhe ka përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) trajnimi i detyruar për (6 persona) punonjësit e emëruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) pranë Drejtorisë të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) trajnimet e nevojshme të lidhura me specifikën e punës të AIDSSH me informacionin e klasifikuar.

Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) trajnimet e nevojshme pranë Drejtorisë të Përgjithshme të

Arkivave (DPA).

Është ndërmarrë dhe ka përfunduar procesi i vlerësimit të ndërmjetëm të rezultateve në punë për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues.

Në mënyrë që AIDSSH të realizojë me sukses misionin e tij kryesor, atë të plotësimit të së drejtës të çdo te interesuari, për informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar dhe për arsye të natyrës dhe volumit të madh të punës konkrete për realizimin e këtij misioni, duhet të zbatohet Vendimi i Kuvendit Nr. 95, datë 22.12.2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, për tu plotësuar sa më shpejtë të jetë e mundur organika e AIDSSH.



PROBLEMATIKA
DHE VËSHITRËSI

Në vitin e parë të punës Autoriteti është përballur me vështirësitë dhe problematikat të cilat kanë konsistuar në:

- ✓ Gjendja e dokumentacionit arkivor jo i gjithë i inventarizuar dhe i përpunuar, që sjell vonesa në marrjen në dorëzim dhënien e përgjigjeve;
- ✓ Vendosja e fondeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit në ambiente të ndryshme, fondi arkivor pranë SHISH, MB, DPA dhe pranë zyrave të AIDSSH;
- ✓ Dekodifikimi i disa prej dosjeve të bashkëpunoreve, vështirohet për shkak të mungesës fizike të dosjeve dhe të mungesës së personelit për të zhvilluar metoda dhe mjete të tjera kërkimi;
- ✓ Mungesa e ambienteve për ushtrimin e veprimtarisë së Institucionit, i cili është vendosur në 8 zyra brenda ambienteve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të mungesës së plotë të fondeve financiare për rikonstruksionin e godinës;
- ✓ Mosplotësimi i strukturës së miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, për shkak të mosmiratimit nga Ministria e Financave;
- ✓ Verifikimi i plotë i gjithë procesverbaleve të asgjësimit dhe pajtueshmëria e këtyre akteve me ligjin e kohës dhe mirë administrimin e vlerave dokumentare, në përputhje me rregulloret dhe evidencat në mënyrë që të dokumentohet çfarë ka ndodhur me ato për të shmangur përgjegjësitë e institucionit tonë.

- ✓ Pamundësia e gjetjes së dokumentacionit mbi fatin e personave të zhdukur apo të pushkatuarve me ose pa gjyq, që nuk u dihen vendvarrimet (25 kërkesa), kur ka një interes të shtuar të publiku, partnerëve dhe faktorit ndërkombëtar, duke gjetur vetëm në një rast procesverbalin e ekzekutimit.
- ✓ Koha e limituar e paraqitjes së kërkesave për kandidatët që zgjidhen ose emërohen, duke iu referuar zgjedhjeve që lamë pas. Nga informacioni që kemi në periudhë zgjedhore KQZ duhet të administrojë për zgjedhjet e Kuvendit rreth 8 mijë kandidatura (lista shumë emërore për kandidat për deputet), të cilat subjektet zgjedhore i paraqesin për miratim në KQZ jo më vonë se 50 ditë para ditës së zgjedhjeve. Duke marrë në konsideratë faktin se KQZ-së për zhvillimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve sipas listave shumë emërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore të regjistruara i duhen 10 ditë për marrjen e vendimit përkatës, faktin që informacioni që grumbullohet e duhet të përpunohet është tepër masiv edhe për Autoritetin, e për rrjedhojë edhe koha për përfundimin e procedurës deri në marrjen e vendimit të Autoritetit rast pas rasti duhet të jetë jo më shumë se 10 ditë, e bën komplekse situatën e paraqitur dhe e vështirëson atë, që e gjithë procedura të mbyllet në kohën e duhur.

PROPOZIME PËR
PËRMIRËSIM

- ✓ Krijimi i arkive bashkëkohore, lehtësisht të aksesueshme, e cila do ti shërbejë informimit të saktë dhe në kohë mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- ✓ Vëmendje të shtuar të trajtimit të kërkesave me objekt, personat e zhdukur dhe për ata që nuk ekzistojnë varre, në gjetjen e mekanizmave për identifikimin e tyre;
- ✓ Përgatitjen cilësore të materialeve informuese mbi dokumente të ish-sigurimit të Shtetit dhe vënien e tyre në dispozicion organizatorëve, në funksion të konferencave, takimeve, ëorkshopeve, programeve trajnuese, me qëllim krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse, për njohje me dokumentacionin arkivor, të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit;
- ✓ Përmirësimin e procedurave të ndjekura, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për subjektet e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për vetë institucionin;
- ✓ Bashkëpunimi dhe ofrimi i asistencës së nevojshme nga Drejtoritë homologe të institucioneve jashtë vendit që operojnë në këtë fushë, në funksion të ecurisë së procesit në përgjithësi dhe ngritjen në standarde pune të Autoritetit në veçanti;
- ✓ Gjetjen e mënyrave dhe mjeteve më efikase për të shpërndarë informacion, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit të qytetarëve dhe rinisë në veçanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që ju përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshëm të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të marra në mënyrë autentike nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit;
- ✓ Krijimi i bazës së të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara deri më sot, por edhe informacioni i disponueshëm, për strukturat operative apo bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, subjekte të verifikuara nga Komisioni, i cili ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 8001/1995 dhe ligjit nr. 8043/1995, të ndryshuar;



REKOMANDIME
DHE DETYRA

7.1 Përfundime

Sa parashtruar më sipër është mbajtur parasysh nga Autoriteti gjatë hartimit të planit të punës për vitin 2018 dhe përbëjnë objektivat e veprimtarisë së tij, për të përmbushur misionin institucional, në drejtim të forcimit të punës me dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, të informimit të subjekteve të interesuara për informimin mbi Dokumentet ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe në drejtim të edukimit qytetar mbi këto dokumente. Në përputhje me misionin dhe vizionin e Institucionit dhe me qëllim përmbushjen e tyre, Autoriteti do të punojë edhe përgjatë vitit 2018 me përkushtim në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 45/2015 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, brenda fushës së veprimtarisë së tij. Për të realizuar misionin, Autoritetit synon që gjatë vitit 2016 të sigurojë mbështetje, me qëllim që të fuqizojë kapacitetet institucionale, si në drejtim të burimeve njerëzore, ashtu edhe financiare. Duhet të sjellim në vëmendjen e aktorëve që menaxhojnë projekte me donatorë të huaj, që të përfshijnë edhe Autoritetin si përfitues në këto projekte, për të fuqizuar këtë institucion dhe për të siguruar veprimtarinë normale të tij.

Pavarësisht vështirësive dhe problematikave të vitit të parë të punës bëjmë prezent se, nga raportimi vjetor i punës së Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, rezulton zhvillimi konstant dhe i qëndrueshëm në drejtim të:

✓ Forcimit të funksionit të ligjit, dhe në drejtim

të forcimit të bashkëpunimit me institucionet vendase dhe të huaja.

- ✓ Plotësimit me aktet nënligjore të Institucionit, me qëllim funksionimin e tij.
- ✓ Rritjes së perceptimit të publikut për punën e institucionit pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe për një institucion të hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm sipas ligjit nr. 45/2015.
- ✓ Zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me informimin e individëve, institucioneve Kushtetuese dhe autoriteteve publike, të medias, studuesve dhe garantimin e transparencës në procesin e informimit.
- ✓ Edukimit qytetar lidhur me zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese në dy fushat e veprimtarisë me institucionet publike private dhe shoqërinë civile

Objektivat e punës së Autoritetit për vitin 2018 do të jenë:

1. Forcimi i kapaciteteve të Autoritetit, me qëllim që ky institucion të përmbushë plotësisht rolin e tij, forcimi i kapaciteteve administrative dhe të burimeve njerëzore, konkretisht:

- ✓ Përfundimi i procesit të rekrutimeve brenda muajit Prill;

- ✓ Trajnimi të specializuara pranë ASPA për financat dhe prokurimet;
- ✓ Trajnime të specializuara për personelin e arkivave, informacionit, mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar;
- ✓ Trajnime të specializuara të personelit pranë DSIK;
- ✓ Trajnime të personelit pranë homologëve anëtarë të Rrjetit Evropian të Autoriteteve Zyrtare për Dokumentet e Policive Sekrete;

1. Sigurimi i Infrastrukturës së nevojshme, e cila konsiston në:

- ✓ Kompletimi i infrastrukturës TIK;
- ✓ Fillimi i procesit, zgjidhjes të integruar të dixhitalizimit;
- ✓ Krijimi i infrastrukturës (ambiente, pajisje) te përshtatshme për studiuesit;
- ✓ Kalimi në një zgjidhje të integruar të aktivitetit të arkivave dhe informacionit;

2. Përfundimi dhe finalizimi për kalimin në administrim të Autoritetit gjithë dokumentacionin arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit nga të gjitha arkivat e autoriteteve publike që i kanë administruar ato.

- ✓ Finalizimi i procesit me Arkivën e Sistemit të Ministrisë së Brendshme dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;
- ✓ Fillimi i punës me fondin arkivor që disponon Arkiva e Sistemit të Ministrisë së Drejtësisë;

3. Rritja e bashkëpunimit me donatorët dhe organizatat homologe:

- ✓ Për të siguruar financime shtesë për konsulencë

të specializuar;

- ✓ Për të siguruar financime shtesë për të shtuar dhe përmirësuar infrastrukturën dhe pajisjet TIK;
- ✓ Për të bërë të mundur trajnime të specializuara të personelit;
- ✓ Për të realizuar objektivat dhe aktivitetet e Planit Strategjik 2017-2012 nëpërmjet hartimit dhe financimit të projekteve të veçanta;

2. Përmirësime ligjore dhe procedurale:

- ✓ Amendime të ligjit nr. 45/2015 lidhur me:
 - i. zgjatjen e afatit të parashikuar në ligj për qëllime të verifikimit të Kërkesa për informim nga kandidatë për t'u zgjedhur afat i cili në ligjin funksional është 31 mars 2020;
 - ii. verifikimin kryesisht dhe jo me kërkesë për kandidatët për t'u zgjedhur si: kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku dhe mbi zyrtarë përpara emërimit ose ngritjes në detyrë.
 - iii. përgjegjësitë konkrete të anëtarëve të autoritetit, rregullimin e marrëdhënieve të tyre të punës, parashikimin e sanksioneve kur nuk zbatojnë detyrat e ngarkuara me ligj.
- ✓ Amendime të Kodit Zgjedhor, miratuar me ligjin nr. 10019/2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, nr. 31/2015, lidhur me afatin kohor që duhet për verifikimin e kandidatëve të që zgjidhen ose emërohen.
- ✓ Përmirësimi i procedurave të informimit nëpërmjet rishikimit të akteve të brendshme të Autoritetit.



A N E K S E

bēnto

jeēē

nat!

e

Aneksi 1

STRATEGJIA PËR VITIN 2017-2020

Dokumenti i Strategjisë për vitet 2017-2020, miratuar me Vendim të Autoritetit nr. 42, datë 22.06.2017 “Për miratimin e Planit Strategjik dhe atij të Veprimit (2017 - 2020) të Autoritetit” ka shërbyer si një dokument udhëzues për aktivitetet e Autoritetit të sapokrijuar. Dokumenti ka për qëllim të ofrojë drejtim dhe fokus për aktivitetet e Autoritetit, duke mundësuar gjithashtu rishikime periodike të qëllimeve dhe objektivave të tij. Nën strategjinë e ndërtuar për vitin 2017-2020 është hartuar plani vjetor 2017, në përmbajtje të të cilit janë vendosur objektivat, aktivitetet që do të zhvillohen për të arritur këto objektiva, afati kohor, struktura përgjegjëse që do të realizojë objektivat, si një dokument provues për arritjen e objektivave. Planit vjetor 2017 ka përcaktuar drejtimet kryesore të punës së Autoritetit për përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin nr. 45/2015, në VKM-në nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e Institucionit.

Për të arritur përmbushjen e detyrave sipas ligjit, Autoriteti është përqendruar të:

- ✓ identifikojë, mbledhë dhe krijojë një arkiv të integruar të të gjitha dokumenteve të

njohura të prodhuara nga/ose të lidhura me veprimtarinë e ish-Sigurimit;

- ✓ bëjë regjistrimet në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e qasjes në informata në formë dixhitale;
- ✓ kthimin e Autoritetit si një burim arkivor qendror, për hulumtimin e aktiviteteve të ish-Sigurimit;
- ✓ të informojë publikun për ekzistencën e Autoritetit si një platformë për të gjithë, për kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri;
- ✓ mbështesë punën e dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë;
- ✓ mbështesë procesin e kërkimit, gjetjes, identifikimit dhe rimëkëmbjes së mbetjeve të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit;
- ✓ mbështesë verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për tu zgjedhur ose emëruar në administratën publike/shtetërore.

Ky mandat kërkon që Autoriteti të punojë si një organ profesional efektiv me personel të përgatitur dhe të angazhuar në gjendje të krijojë partneritet me homologët vendas dhe ndërkombëtarë. Si një institucion i sapo krijuar, AIDSSH ka pasur si qëllim që gjatë punës së tij të implementojë eksperiencat më të mira ndërkombëtare në mënyrë që në një kohë sa më të shkurtër të arrijë në nivelin e Institucioneve homologe të Gjermanisë, Bullgarisë, Polonisë, Rumanisë, Çekisë, Sllovakisë etj..

Qëllimi i ligjit nr. 45/2015 është mundësimi i ushtrimit të së drejtës nga çdo i interesuar për tu informuar mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, duke mbrojtur personalitetin dhe jetën private të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar. Për të përmbushur këto detyrime, Autoriteti udhëhiqet nga vlerat e transparencës, integritetit, bashkëpunimit, mësimit dhe angazhimit pro aktiv. Ai mishëron thirrjen e Parlamentit Evropian për të mbajtur gjallë kujtimin e së kaluarës, pasi nuk mund të ketë pajtim pa të vërtetën dhe përkujtimin;

- ✓ Riafirmon qëndrimin e Shqipërisë kundër sundimit totalitar të çfarëdo forme apo prejardhje ideologjike;
- ✓ Respekton vlerat evropiane të drejtave dhe dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë dhe sundimit të ligjit.
- ✓ Konsolidon në një arkiv të vetëm të gjitha dokumentet e prodhuara nga ish-Sigurimi i Shtetit;
- ✓ Të sigurojë qasje të rregullt në informacionin në dosje në përputhje me dispozitat e ligjit;
- ✓ Të zhvillojë kërkime, kurse arsimore dhe kurrikula, të angazhohet me publikun nëpërmjet komunikimit strategjik;
- ✓ Skanimin e individëve që kërkojnë të aplikojnë në detyra publike për lidhjet me ish-sigurimin të shtetit.

Dokumenti strategjik përcakton se Autoriteti ka si vizion të tij: i) Sigurimin e një platforme të besueshme, për të hyrë në trashëgiminë e madhe dokumentare të ish-Sigurimit të Shtetit;

ii) Angazhimin e qytetarëve shqiptarë të të gjitha prejardhjeve duke siguruar të dhëna, informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit mbi përvojën e shtypjes komuniste; iii) Ekzistencën e një burim i arritshëm dhe jetik për të vlerësuar eksperiencën shqiptare në komunizëm në mënyrë mos përsëritjen në të ardhmen gabimet e së shkuarës. Në vijim të Planit Strategjik dhe atij të Veprimit 2017-2020, është hartuar plani vjetor i punës për vitin 2017 duke patur parasysh objektivat strategjike:

Sigurimi i qasjes në të dhënat e Sigurimit

- Objektivi Strategjik 1.1 - Identifikimi, mbledhja dhe krijimi i një arkivi të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura të prodhuara nga ose të lidhura me veprimtarinë e Ish-Sigurimit.

Nxitja e Kërkimit dhe Edukimit Publik

- Objektivi strategjik 1.2 – Bërja e të dhënave të disponueshme për publikun sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë dhënien e informacionit në formë digjitale.
- Objektivi Strategjik 2.1 - Themelimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit.
- Objektivi Strategjik 2.2 - Kryerja e veprimtarive në terren për ta prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri

Lehtësimi i përdorimit nga institucionet publike dhe qytetarët që kërkojnë informacion

- Objektivi strategjik 4.1 - Mbështetja e verifikimit të zyrtarëve që konkurrojnë për tu zgjedhur ose emërimin në detyra publike.
- Objektivi strategjik 4.2. – Informimi i kërkuar për dokumentet e ish sigurimit të shtetit

Promovimi i Transparencës dhe Drejtësisë Tranzicionale

- Objektivi strategjik 3.1 - Mbështetja e punës së dokumentimit të krimeve të komunizmit,

përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë.

- Objektivi strategjik 3.2 - Mbështetja e procesit të identifikimit dhe gjetjes së eshtrave të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit (Nevojiten ndryshime ligjore)

Objektivat e menaxhimit

- Objektivi 1 - Themelimi i autoritetit si një trup profesional
- Objektivi 2 - Përmirësimi i Angazhimit, Zhvillimit dhe Produktivitetit të Punonjësve
- Objektivi 3 – Përdorimi i aseteve për ndërtimin e partneriteteve dhe burimeve.

Aneksi 2

I. Fonde të identifikuara në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit

I.1 Fondi i zbulimit


Nr.	Emërtimi i fondeve	Dosje dhe fashikuj
1.	Ish-Drejtorja e II	5 206
2.	Fondi i veçantë	2 740
3.	Fondi i Kosovës	11 489
4.	Fondi i të arratisurve	6 724
5.	Fondi i emigrantëve ekonomikë	4 752
6.	Fondi i të huajve	12 392
1.	Mikrofilma	453

I.2 Fondi kundërzbulimit ish-degët e Punëve të Brendshme

Nr.	Emërtimi i fondeve	Dosje
1.	Dosje RSI (bashkëpunëtorë)	10 733
2.	Dosje përpunimi (2A/2B)	11 987
3.	Dosje drejtimi (dëna volume)	907
4.	Dosje kërkimi dhe zbulim autori	778
5.	Dosje objekt i rëndësisë së veçantë	533
6.	Fashikuj të ndryshëm (vizitor, turist, të dënuar, specialistë të huaj	1 174
7.	Dosje agjenturore	459
8.	Dosje me probleme të centralizuara	526
9.	Regjistra të ndryshëm (agjente përpunimi)	842
10.	Proçesverbale, lista veçimi, statistika, evidenca	4 480
11.	Njësi të tjera ruajtje (libra, tema etj.)	2 000
1.	Kartela	215 790

I.3 Fondi i arkivës së Sistemit të Ministrisë së Brendshme

Nr.	Fonde	Dosje fizike	Fletë xhaketina	Copë kartela
1.	Fondi i dosjeve administrative (Drejtori I, II, III dhe ish-Degët e Punëve të Brendshme në Rrethe)	90 345	2 250	-
2.	Fondi i dosjeve hetimore – gjyqësore	14 000	40 000	-
3.	Fondi i dosjeve të personelit të ish MPB	15 000	-	-
4.	Fondi i dosjeve operative	-	12 470	-
5.	Fondi i krijuar nga funksionimi i ligjit Nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.	264	-	-
6.	Fondi i dosjeve të rrjetit sekret (dosje pune dhe personale)	1 642	-	-
7.	Fondi i dosjeve të përpunimit	158	-	-
8.	Fondi i regjistrimeve audio - vizive	-	-	-
9.	Bobina	492		
10.	Katalogë alfabetikë	113	-	-
11.	Kartelat model 1	-	-	21 000
12.	Kartela me të dhënat nga dosjet hetimore-gjyqësore	-	-	14 700



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT